



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 126

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 24 korrik 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 14, datë 18.7.2024	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2023–2024 (sesioni i dytë) 15675
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 11.6.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-1247(150), datë 11.5.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për sa i përket të gjykuarit Françesk Vala, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 15675
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 49, datë 20.6.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 1195 akti, datë 15.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 183, datë 1.2.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-1151, datë 3.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 15683
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 19.6.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 15697
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 120, datë 19.6.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 15698
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 121, datë 19.6.2024	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 15699
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 122, datë 19.6.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “FU-GEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 15700
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 123, datë 19.6.2024	Mbi fillimin e procedurës, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 15702

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 124, datë 19.6.2024	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw”, të ndryshuar.....	15703
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 125, datë 19.6.2024	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k.....	15704
Kërkesë e Agjencia Shtetërore për Shpronësimin nr. 922/9, datë 22.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimet të ‘Unazës së Madhe’ Tiranë nga ‘Sheshi Shqiponja’–‘Bulevardi i Ri’ dhe ‘Rikualifikimi i ‘Unazës Lindore’ për lotet 4, 5, 6’, (faza 2)”.....	15705
	Korrigjim gabimi në njoftimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 4719, datë 27.3.2024, “Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Republikën e Italisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 5.4.2024.....	15707



UDHËZIM

Nr. 14, datë 18.7.2024

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E PROVIMEVE KOMBËTARE TË
ARSIMIT BAZË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË, VITI SHKOLLOR
2023–2024 (SESIONI I DYTË)**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 26 dhe pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të urdhrin nr. 565, datë 5.10.2023, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Nina Guga”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, për vitin shkollor 2023–2024 (sesioni i dytë), të zhvillohen në datat si më poshtë:

- Lënda “Gjuhë shqipe”, më 20 gusht 2024;
- Lënda “Matematikë”, më 26 gusht 2024;
- Lënda “Gjuhë e huaj” e parë, më 30 gusht 2024;
- Lënda “Gjuhë amtare”, për nxënës të pakicave kombëtare, më 21 gusht 2024.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare vlerësohen në lëndët: “Gjuhë amtare”, “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe sipas dëshirës edhe në një gjuhë të huaj.

3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 74, datë 15.2.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë”.

4. Gjuhët e huaja që do të jepen si provim i detyruar janë: “Anglisht”, “Frëngjisht”, “Italisht” dhe “Gjermanisht”. Testi i gjuhës së huaj të parë hartohet në përputhje me gjuhën e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze,

italiane dhe gjermane japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

6. Çdo provim kombëtar i arsimit bazë fillon në orën 10:00 dhe zgjat 2 orë e 30 minuta.

7. Nxënësit me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare të arsimit bazë, sipas përcaktimeve në rregulloren për zhvillimin e PKAB-së.

8. Drejtuesi i Institutit të nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi” e tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QShA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *Brail*.

9. Çdo zyre vendore e arsimit parauniversitar merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe në QShA.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Nina Guga

VENDIM
Nr. 46, datë 11.6.2024

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;



Ilir Toska, anëtar;
Genti Ibrahim, anëtar;
Marjana Semini, anëtare;
Sandër Beci, anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 11.6.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen 15 (F) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Francesk Vala, përfaqësuar nga avokat Fahri Danaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokuror Alfred Progonati, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1247(150), datë 11.5.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për sa i përket të gjykuarit Françesk Vala, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, pikat 1 dhe 2, 18, pika 1, 23, pika 1, 32, pika 2, 33, pika 1, 42, pikat 1 dhe 2, 43, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Françesk Vala është hetuar dhe proceduar penalisht për kryerjen e veprave penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 109, paragrafi 1, 25 dhe 278, paragrafi 1, të Kodit Penal (*KP*) për shkak se në bashkëpunim me shtetasit P. D., P. D., K. D., T. Sh. dhe L. Sh., me të

cilët kishte marrëdhënie shoqërore, ka marrë peng, shoqëruar dhe mbajtur për disa ditë shtetasin S. K. dhe vëllain e tij A. K. (*kallëzuesi*). Ka rezultuar se marrja peng e këtyre shtetasve është bërë për shkak të një marrëveshjeje të papërfunduar ndërmjet shtetasit P. D. dhe një shtetasi tjetër nga Mali i Zi për blerjen e 16 kilogramëve lëndë narkotike *cannabis sativa* kundrejt shumës 10,000 euro, marrëveshjeje që është kryer në prani të shtetasit S.K.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 27, datë 11.4.2017, mbi bazën e kërkesës së mbrojtjes së kërkuarit, ka gjykuar çështjen sipas ritit të gjykimit të shkurtuar dhe në përfundim ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim, si dhe deklarinimin fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së, dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Bazuar në nenin 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, kërkuari është dënuar me 12 vjet burgim dhe në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), është dënuar përfundimisht me 8 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kërkuari ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 59, datë 21.7.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe deklarinimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109, paragrafi i tretë dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim, ndërkohë që ka lënë në fuqi vendimin e ankimuar për veprën penale të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së. Bazuar në nenin 55 të KP-së, gjykata e apelit e ka dënuar kërkuarin me 12 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406, pika 1, të KPP-së e ka dënuar përfundimisht atë me 8 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kërkuari ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1247(150), datë 11.5.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se ajo gjykatë e ka argumentuar vendimmarrjen në përputhje me provat e marra e të



verifikuara në këtë gjykim, në konformitet me kërkesat e ligjit penal material e procedural dhe se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton në cenim të të drejtave themelore ose të garancive procedurale të kërkuarit. Sipas Kolegjit Penal, në kohën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, dhënia e një cilësimi juridik më të rëndë për faktin penal nuk parashikohej në nenin 425, pika 3, të KPP-së si ndalim ligjor për atë gjykatë kur apelues ishte vetëm i pandehuri. Në këtë kuptim, pretendimi se gjykata e apelit ka disponuar në kundërshtim me sa parashikon kjo dispozitë procedurale nuk është i bazuar.

5. Në datën 14.11.2023, kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 30.11.2023. Me vendimin e datës 9.2.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuarisi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

6.1 *Parimit të mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit (reformatio in peius)*, pasi në kundërshtim me nenin 425, pika 3, të KPP-së, kur apelues është vetë i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurie më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar dhe as t'i japë faktit cilësim juridik më të rëndë. Gjykata e apelit ka arritur në përfundimin e gabuar se kërkuarisi ka kryer veprën penale të rrëmbimit të personit.

6.2 *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi gjykimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është bërë në mungesë të kërkuarit. Në kushtet kur ai është arrestuar gjatë kohës së gjykimit të çështjes në Gjykatë të Lartë, duhej të pyetej dhe dëgjohej në lidhje me akuzat. Për kërkuarisen faza e hetimeve paraprake dhe e gjykimit në të tria shkallët është mbyllur pa u dëgjuar asnjëherë.

6.3 *Parimit të prezumimit të pafajësisë (in dubio pro reo)*, pasi nuk ekziston asnjë provë, në kuptimin ligjor të saj, që vërteton praninë e kërkuarit në vendngjarje ose që ai të ketë kryer ndonjë veprim të kundërligjshëm, të tillë që të përmbajë elementet e

veprës penale të parashikuar nga neni 109 i KP-së. Nuk është provuar se kërkuarisi ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ndërkohë që gjykatat kanë ligjëruar veprimet hetimore dhe konkluzionet e organit të akuzës, të cilat janë bazuar në të dhëna hipotetike dhe të pashoqëruara me prova të pakundërshtueshme.

7. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

7.1 Për pretendimin e cenimit të *parimit të mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit* kur çështja shqyrtohet mbi ankimin e tij, referuar kohës në të cilën është gjykuar çështja penale në gjykatën e apelit, dhënia e një cilësimi juridik më të rëndë për faktin penal nuk parashikohej në nenin 425, pika 3, të KPP-së si ndalim ligjor për gjykatën e apelit. Kolegji Penal ka evidentuar se gjykata e apelit, pavarësisht se i ka dhënë faktit një cilësim juridik të ri (në dukje më të rëndë), ndryshe nga organi i akuzës, nuk e ka ndryshuar masën e dënimit. Neni 425 i KPP-së, në fuqi në kohën e gjykimit në apel, e lidhte rëndimin e pozitës së të pandehurit me rritjen e masës së dënimit dhe jo me kualifikimin ligjor të faktit penal. Kjo dispozitë nuk e ndalonte gjykatën e apelit që t'i jepte faktit penal një cilësim juridik të ri qoftë dhe më të rëndë në dukje. Gjykata e apelit nuk ka ndryshuar masën e dënimit, duke lënë në fuqi atë të caktuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo ka rikualifikuar të njëjtin fakt penal që ishte përshkruar në aktin për njoftimin e akuzës dhe në kërkesën për gjykim, dhe jo një fakt të ri, i cili përmbante element të ri, që nuk i ishte njoftuar të gjykuarve. Cilësimi i duhur juridik i veprimeve të ndërmarra nga secili prej bashkëpjesëmarrësve në këtë vepër penale, nuk çon në rëndim të pozitës së tyre. Kërkuarisi nuk i është mohuar asnjë e drejtë, pasi është njohur në mënyrë të detajuar me faktin penal, provat dhe akuzën në ngarkim të tij.

7.2 Për sa i përket pretendimit për *cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar*, gjatë gjykimit kërkuarisi i është garantuar akses i gjykatë si nga ana formale, ashtu edhe substanciale. Sikurse rezulton nga aktet, kërkuarisi, në shkallë të parë dhe në apel, është përfaqësuar me avokat të zgjedhur prej tij, duke zgjedhur, me vullnet të lirë, që të drejtën për akses dhe të drejtat e tjera në gjykim t'i ushtronte nëpërmjet mbrojtësit. Nuk rezulton që mbrojtësi i zgjedhur të mos ketë ushtruar të drejtat që i ka deleguar kërkuarisi. Nga ana tjetër, kërkuarisi ka marrë përgjigje për



kërkesat e tij nga Gjykata e Lartë, e cila ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë e ligjit, duke pasqyruar në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta.

7.3 Pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* është i pabazuar, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë bazuar vendimet e tyre në një sërë provash, të tilla si akte shkresore, thënie të dëshmitarëve etj. dhe gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit ato nuk kanë arritur në asnjë konkluzion *apriori* për fajësinë e tij. Gjykatat nuk rezultojnë që të kenë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik subjekt i së drejtës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës

së Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 11.5.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 14.11.2023. Sipas informacionit zyrtar të vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë, vendimi i kësaj gjykate është bërë i disponueshëm për palët në datën 27.7.2023, e cila konsiderohet si data nga e cila për kërkuesin fillon afati ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, kërkesa konsiderohet e paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të parimit të mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit (*reformatio in peius*), së drejtës për t’u dëgjuar dhe parimit të prezumimit të pafajësisë.

13. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, konstaton se ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit “Arresti në burg”, e cila nuk është ekzekutuar për shkak të largimit të tij. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesi ka zgjedhur t’i fshihet drejtësisë, ndaj për këtë shkak dhe në bazë të nenit 33, pika 2, të Kushtetutës, ai nuk mund të përfitojë nga e drejta për t’u dëgjuar. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkuesi, me prokurë të posaçme, ka zgjedhur personalisht mbrojtësin B. B., të cilit i ka dhënë të drejtën për ta përfaqësuar në prani dhe në mungesë të tij në të gjitha shkallët e gjykimit. Ky mbrojtës rezultojnë se ka marrë pjesë në procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuesit dhe ka parashtruar përpara gjykatës kërkimet në emër dhe për llogari të këtij të fundit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

14. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e parimit të *prezumimit të pafajësisë* dhe atij *in dubio pro reo*, sipas nenit 30 të Kushtetutës kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se parimi i prezumimit të pafajësisë ka kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me



bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky parim kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 13, datë 24.4.2018; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se kërkuesi, në mbështetje të këtij pretendimi, ka parashtruar se nuk ekziston asnjë provë, në kuptimin ligjor të saj, që vërteton praninë e tij në vendngjarje ose që të ketë kryer ndonjë veprim të kundërligjshëm, të tillë që të përmbajë elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 109 i KP-së. Sipas tij, nuk është provuar se ai ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ndërkohë që gjykatat kanë ligjëruar veprimet hetimore dhe konkluzionet e organit të akuzës, të cilat janë bazuar në të dhëna hipotetike dhe të pashoqëruara me prova të pakundërshtueshme.

16. Gjykata, bazuar në këto pretendime të kërkuesit, si edhe në përmbajtjen e vendimeve gjyqësore që e kanë deklaruar atë fajtor dhe e kanë dënuar, konstaton se nuk rezultojnë të dhëna që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ta kenë filluar procesin me bindjen se kërkuesi e kishte kryer krimin për të cilin akuzohej dhe as që barra e provës për faktin penal dhe fajësinë t'i ketë kaluar atij. Gjykata gjithashtu konstaton se vendimet gjyqësore janë bazuar në aktet dhe provat shkresore të procedimit penal, për vlefshmërinë apo përdorimin e të cilave kërkuesi dhe mbrojtësi i tij nuk kanë pasur asnjë kundërshtim, madje kanë pranuar se çështja penale mund të zgjidhej bazuar vetëm në to, pa pasur nevojë për paraqitjen e provave të reja prej tyre. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

17. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesit për *cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit (reformatio in peius)*, Gjykata vëren se ky pretendim është me natyrë kushtetuese dhe për

nga natyra e tij dhe thelbi i argumenteve të parashtruara nga kërkuesi do të analizohet në vijim, në drejtim të bazueshmërisë së tij në themel, i lidhur me të drejtën e ankimit, të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit (reformatio in peius) të lidhur me të drejtën e ankimit

18. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e dhëna nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë janë në kundërshtim me nenin 425, pika 3, të KKP-së, i cili ndalon gjykatën që në rastin kur apelues është vetë i pandehuri të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurie më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar dhe t'i japë faktit cilësim juridik më të rëndë. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit, në kundërshtim me këtë dispozitë, edhe pse është vënë në lëvizje me ankimin e tij, i ka dhënë një cilësim më të rëndë faktit penal.

19. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se neni 425, pika 3, i KPP-së, në fuqi referuar kohës në të cilën është gjykuar çështja penale në gjykatën e apelit, nuk ndalonte dhënien e një cilësimi juridik më të rëndë për faktin penal kur apelues ishte i pandehuri. Sipas këtij subjekti, gjykata e apelit nuk ka ndryshuar masën e dënimit, duke lënë në fuqi atë të caktuar nga gjykata e shkallës së parë dhe ka argumentuar vendimarrjen për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal, fakt që nuk ndryshon nga sa është parashtruar në aktin e njoftimit të akuzës nga prokuroria apo në vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas tij, gjykata e apelit nuk ka analizuar një fakt të ri që nuk i ishte njoftuar kërkuesit, ndaj cilësimi i duhur juridik i veprimeve të ndërmarra nga secili prej bashkëpunëtorëve në këtë vepër penale, duke referuar në provat konkrete, nuk ka çuar në rëndim të pozitës.

20. Gjykata është shprehur se parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformatio in peius*) është i lidhur me garancinë e aksesit në gjykatë si element i procesit të rregullt. Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, por ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues. Zbatimi i këtij parimi është një garanci më shumë për të gjykuarin, me



qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës. Ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 45, datë 3.7.2017; nr.15, datë 22.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po sipas Gjykatës, për sa i përket së drejtës së ankimit, sipas nenit 43 të Kushtetutës kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Kjo e drejtë është vlerësuar nga Gjykata si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individi) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimet nr. 45, datë 3.7.2017; nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 38, datë 30.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. E drejta kushtetuese e ankimit është materializuar në dispozitat procedurale penale. Kështu, neni 410 i KPP-së parashikon të drejtën e të pandehurit për të bërë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij, ndërsa neni 425 i KPP-së, në fuqi në kohën e gjykimin të çështjes në gjykatën e apelit, parashikonte se kjo e fundit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Kjo dispozitë përcaktonte, gjithashtu, edhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata e apelit në rastet kur ankues ishte vetëm i pandehuri duke parashikuar, në pikën 3 të saj, se në rastin e ankimit vetëm nga i pandehuri gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë apo t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar.

23. Kurse në lidhje me konceptin kushtetues të dënimit penal, në jurisprudencën kushtetuese është vlerësuar se ai është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjithë elementët juridikë të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Sipas nenit 47 të KP-së, në caktimin e dënimit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese (*shih vendimet nr. 9, datë 26.2.2016; nr. 47, datë 27.6.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për sa më sipër, duke qenë se pretendimet kryesore të kërkuarit lidhen me përkeqësimin e pozitës juridike të tij, për shkak të ricilësimit juridik të veprës penale nga gjykata e apelit, pavarësisht se ajo nuk ka ndryshuar masën e dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata çmon të analizojë nëse ricilësimi i veprës penale përbën, në kuptim të nenit 425 të KPP-së, dënim më të rëndë dhe, për pasojë, sjell përkeqësim të pozitës së të pandehurit, në kushtet kur gjykata e apelit është vënë në lëvizje vetëm mbi bazën e ankimit të tij, në një procedurë me gjykim të shkurtuar, e cila është bazuar në akuzën sipas cilësimit juridik të veprës penale në gjykatën e shkallës së parë. Në këtë drejtim, Gjykata do të analizojë nëse koncepti i dënimit përmban, ndër të tjera, edhe ricilësimin/cilësimin e veprës penale si element përbërës të tij.

25. Gjykata, bazuar në faktet me natyrë kushtetuese të kësaj çështjeje, vëren se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka deklaruar fajtor kërkuarin për kryerjen e veprës penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së, duke e dënuar me 11 vjet burgim, dhe të veprës penale “Prodhiimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së, duke e dënuar atë me 3 vjet burgim. Në zbatim të parashikimeve të nenit 55 të KP-së për bashkimin e dënimeve, si dhe të nenit 406 të KPP-së për gjykimin e shkurtuar, në



përfundim kërkuesi është dënuar me 8 vjet burgim. Sipas gjykatës së shkallës së parë ka rezultuar e provuar se të pandehurit, në bashkëpunim, kanë rrëmbyer dhe mbajtur peng viktimën e veprës penale, lirimi i të cilit nuk është bërë me vullnetin e të pandehurve, por si rezultat i operacionit të forcave të policisë, pra lirimi i tij ka qenë i detyruar.

26. E vënë në lëvizje vetëm mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka ndryshuar vendimin e mësipërm të gjykatës së shkallës së parë vetëm për pjesën që e ka deklaruar atë fajtor për veprën penale të parashikuar nga nenet 109, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së, duke e lënë në fuqi për veprën tjetër penale, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së. Gjykata e apelit e ka deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprës penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109, paragrafi i tretë dhe 25 të KP-së dhe e ka dënuar për këtë vepër penale me 11 vjet burgim. Në përfundim, bazuar në nenin 55 të KP-së, gjykata e apelit e ka dënuar kërkuesin me 12 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406, paragrafi i parë, të KPP-së e ka dënuar përfundimisht me 8 vjet burgim. Për ndryshimin, për sa i përket cilësimit të veprës penale, ajo gjykatë ka arsyetuar se është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se shtetasi A. K. është lënë i lirë nga të pandehurit me kusht që të siguronte dhe dorëzonte shumën 10,000 euro. Kushti i vendosur prej tyre për lirimin e shtetasit A. K. përcaktohet në nenin 109 të KP-së, por edhe pse të pandehurit kanë rënë dakord që pas plotësimit të kushtit të lironin edhe pengun tjetër, vëllain e tij S. K., kjo nuk i përjashton ata nga zbatimi i këtij neni, pasi qëllimi ka qenë përfitimi i paligjshëm. Nga ana tjetër, sipas asaj gjykate, privimi i lirisë, i shoqëruar me mundime fizike dhe psikike, me qëllim për të arritur një përfitim të paligjshëm siç është çmimi i lirimit të pengut, parashikohet nga paragrafi 3 i nenit 109 të KP-së. Për këtë arsye, sjellja e paligjshme, e kryer nga të pandehurit në bashkëpunim, duhet të kualifikohet në paragrafin 3, të nenit 109 të KP-së. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs kërkuesi, duke pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit penal, pasi ka shmangur detyrimin që rrjedh nga pika 3, e nenit 425 të KPP-së, e cila lidhet me

mosrëndimin e pozitës së të gjykuarit kur çështja shqyrtohet mbi bazën e ankimit të tij.

27. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se ajo e ka argumentuar vendimmarrjen e saj në përputhje me provat e marra e të verifikuara në këtë gjykim, në konformitet me kërkesat e ligjit penal material e procedural dhe vendimi i saj nuk rezulton në cenim të të drejtave themelore ose të garancive procedurale të kërkuesit. Kolegji Penal, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimin për zbatimin e nenit 425, pika 3, të KPP-së, ka vlerësuar se në kohën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, dhënia e një cilësimi juridik më të rëndë për faktin penal nuk parashikohej në atë dispozitë si ndalim ligjor për këtë gjykatë kur apelues ishte vetëm i pandehuri. Sipas Gjykatës së Lartë, pavarësisht se, ndryshe nga organi i akuzës, gjykata e apelit i ka dhënë faktit një cilësim juridik të ri, në dukje më të rëndë, ajo nuk ka ndryshuar masën e dënimit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë, por duke lënë në fuqi masën e dënimit, gjykata e apelit ka qenë shumë e kujdesshme në disponimin e saj, për të mos rënduar pozitën e kërkuesit, në zbatim të drejtë të nenit 425, pika 3, të KPP-së.

28. Gjykata konstaton se vepra penale për të cilën kërkuesi është akuzuar nga organi i akuzës dhe është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ka qenë ajo e parashikuar nga paragrafi i parë, i nenit 109 të KP-së, i cili përcakton se rrëmbimi dhe mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve, dënohet me burgim nga 10 deri 20 vjet. Në paragrafin e tretë të kësaj dispozite parashikohet se rrëmbimi ose mbajtja peng e personit e paraprirë ose e shoqëruar me tortura fizike ose psikike, kur është kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet. Ndërsa sipas paragrafit të parë, të nenit 109 të KP-së masa e dënimit është deri në 20 vjet burgim, për kryerjen e saj sipas paragrafit të tretë kjo masë dënohet në minimumin e saj me 20 vjet burgim. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh këto parashikime të nenit 109 të KP-së rezulton se cilësimi juridik i veprës penale sipas paragrafit të



tretë të KP-së është më i rëndë se ai sipas paragrafit të parë të po këtij neni.

29. Gjykata, fillimisht, vëren se neni 425 i KPP-së, në kohën e paraqitjes së apelit të kërkuarit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, parashikonte se kur apelues ndaj një vendimi penal fajësie ishte vetëm i pandehuri, gjykata ndalohej të caktonte një dënim më të rëndë, pa u shprehur nëse koncepti i dënimit përfshinte ose jo edhe cilësimin juridik të veprës penale. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, përmbajtja e pikës 3, të nenit 425 të KPP-së ka këtë përmbajtje: “Kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, ... dhe as t’i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë.”.

30. Në këto rrethana, Gjykata vëren se në kohën e dhënies së vendimit nga gjykata e apelit, neni 425 i KPP-së ishte i pandryshuar dhe gjykata e apelit e ka interpretuar literalisht atë në rastin e kërkuarit, pa analizuar frymën e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit në procesin penal. Ky vendim është dhënë nga gjykata e apelit në datën 21.7.2017, në momentin kur ndryshimet ligjore të saj ishin miratuar në datën 30.3.2017, ishin publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 97, në datën 5.5.2017 dhe hyrja në fuqi e tyre ishte çështje ditësh, më 1.8.2017. Duke analizuar ndryshimin ligjor të dispozitës, Gjykata konstaton se ligjvënësi, duke shtuar shprehjen “dhe as t’i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë”, në rastin kur vendimi i fajësisë apelohej vetëm nga i pandehuri, ka saktësuar përmbajtjen e normës nën dritën e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, duke ndaluar tashmë në mënyrë të shprehur gjykatën e apelit që të ndryshojë cilësimin e veprës penale, sepse një ndryshim i tillë përkeqëson në thelb pozitën e të pandehurit ankes.

31. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se cilësimi juridik i veprës penale është pjesë e konceptit kushtetues të dënimit penal, pasi ai ndikon drejtpërdrejt në individualizimin e veprës penale, si dhe përcakton llojin dhe kufijtë e dënimit. Në këtë pikëpamje, kur gjykata e apelit vihet në lëvizje vetëm mbi ankimin e individit, siç ka ndodhur në rastin konkret, ajo gjykatë nuk mund të ushtrojë diskrecion për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës, duke rënduar pozitën e individit.

32. Në këtë kuptim, interpretimi i Gjykatës së Lartë se gjykata e apelit edhe pse ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës, nuk ka ndryshuar masën e dënimit të dhënë për kërkuarin, është një interpretim i ngushtë që ajo i ka bërë përmbajtjes së nenit 425, pika 3, të KPP-së, duke cenuar jo vetëm thelbin e parimit *reformatio in peius*, por edhe thelbin e së drejtës së ankimit të të pandehurit në një gjykatë më të lartë. Në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse gjykata e apelit nuk ka ndryshuar masën e dënimit për kërkuarin, pra duke e dënuar atë me të njëjtën masë dënimi për të cilën gjykata e shkallës së parë e kishte dënuar sipas paragrafit të parë të nenit 109 të KP-së, kjo nuk ka asnjë rëndësi në rastin konkret për sa kohë që zbatimi i nenit 425, pika 3, të KPP-së nuk lidhet vetëm me masën e dënimit të dhënë nga gjykata, por edhe me cilësimin juridik të veprës sipas parashikimeve të nenit 109 të KP-së. Çdo qëndrim i ndryshëm nuk do të përputhej me qëllimin e ligjvënësit dhe do të vinte në dyshim qëllimin e këtij instituti në drejtim të garantimit të të drejtave të të pandehurit në procesin penal.

33. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos marrë parasysh pretendimet e kërkuarit të parashtruara në rekurs në lidhje me mënyrën e zbatimit të nenit 425, pika 3, të KPP-së nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, e cila edhe pse është vënë në lëvizje vetëm mbi ankimin e kërkuarit ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, për më tepër në kushtet që ai nuk ka pasur të drejtën të mbrohet në lidhje me të, ka cenuar parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit në procesin penal, si një nga elementet thelbësore të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit (*reformatio in peius*) është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të



Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-1247(150), datë 11.5.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për pjesën respektive që i përket të gjykuarit Françesk Vala, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 11.6.2024.

Shpallur, më 18.7.2024.

Kryetar: Holta Zaçaj

Anëtar: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Elsa Toska

Anëtar kundër¹: Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 49, datë 20.6.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.6.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 34 (Sh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

¹ Gjyqtare Sonila Bejtja votoi për rrëzimin e kërkesës me argumentin se në rastin konkret pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit *reformatio in peius* është i pabazuar, pasi në lidhje me këtë pretendim kërkuar ka marrë përgjigje shteruese nga vendimi i Gjykatës së Lartë, në paragrafët 29 dhe 30 të tij.

KËRKUES: Shaban Kapllanaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokuror Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1195 akti, datë 15.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 183, datë 1.2.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-1151, datë 3.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 21, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, si dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 1.9.2016, patrulla e shërbimeve të rendit ka raportuar se një person i moshës rreth 25 vjeç është ngjitur në zyrat e kompanive ajrore në brendësi të terminalit të aeroportit “Nënë Tereza”, Rinas dhe më pas është hedhur nga një distancë prej rreth 8 metrash. Pavarësisht ndihmës së parë mjekësore nga mjeku i aeroportit, ai nuk ka mundur t’u mbijetojë plagëve të marra dhe ka ndërruar jetë në spital. Personi i hedhur është identifikuar si shtetasi J. K., i biri i shtetasit Shaban Kapllani (*kërkuar*).

2. Mbi bazën e materialeve të referuara për ngjarjen nga Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë për Kufirin dhe Migracionin, aeroporti



“Nënë Tereza”, Rinas, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*) ka regjistruar procedimin penal nr. 8543 për veprën penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal (KP). Në përfundim të hetimeve, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), sipas përmbajtjes së kohës, me vendimin e datës 12.6.2017, Prokuroria e Tiranës ka vendosur pushimin e procedimit penal, për shkak të mosplotësimit të elementeve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 99 i KP-së.

3. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për pushimin e procedimit penal, duke pretenduar, ndër të tjera, se forcat e rendit dhe sigurisë të Policisë së Shtetit dhe policia private e aeroportit nuk kanë marrë masa për të penguar ngjarjen, si dhe organi i prokurorisë nuk ka kryer hetimet e nevojshme për përcaktimin e rrethanave të saj dhe ka hetuar për veprën e gabuar penale. Me vendimin nr. 1195 akti, datë 15.12.2017, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës, si të pabazuar në ligj e në prova, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorisë.

4. Ndaj vendimit të gjykatës së rrethit kërkuesi ka ushtruar ankim, për të cilin Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 183, datë 1.2.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, ndërsa për rekursin e kërkuetit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1151, datë 3.7.2023, ka vendosur mospranimin.

5. Në datën 20.12.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27, të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 29.12.2023.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se janë cenuar:

6.1 *E drejta e jetës*, e garantuar nga neni 21 i Kushtetutës, pasi:

6.1.1 Nga ngjitja e të birit sipër zyrave të kompanive ajrore në brendësi të aeroportit dhe deri në hedhjen e tij, Policia e Shtetit dhe punonjësit e sigurisë nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për

parandalimin e ngjarjes ose që pasojat të ishin më të lehta.

6.1.2 Organi i ndjekjes penale nuk ka kryer hetime efektive në drejtim të zbardhjes së rrethanave të ngjarjes ku ka gjetur vdekjen i biri. Kështu, në gjykim ai ka kërkuar të kryhen një sërë veprimesh hetimore në lidhje me përcaktimin e organeve përgjegjëse që kishin detyrimin për sigurimin e jetës së të birit e të veprimeve të kryera nga ana e tyre, pyetjen e personave të tjerë në detyrë, kryerjen e hetimeve për lëvizjet e të birit nga momenti i mbërritjes së avionit deri në çastin e hedhjes së tij, sqarimin e pasaktësive në raportet e shërbimit të mbajtura ditën e ngjarjes, kryerjen e një ekspertimi të plotë teknik-sinjalistik, si dhe marrjen e provave të tjera për përcaktimin e rrethanave të ngjarjes. Pretendimet e tij për mosveprimet e kryera nga prokuroria nuk janë marrë parasysh nga gjykata. Po kështu, organi i prokurorisë ka hetuar për veprën penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, ndërkohë që në rastin konkret nuk bëhet fjalë për këtë vepër penale, sipas përcaktimit të KP-së, por për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i këtij kodi, me pasojë vdekjen e personit.

6.2 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.2.1 *Së drejtës së aksesit*, pasi ai nuk është njoftuar për datën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Apelit Tiranë. Njoftimi që i është dërguar nga kjo gjykatë është kthyer nga shërbimi postar me shënimin “*Adresë e paplotë*”, ndonëse adresa ka qenë e saktë dhe në të ka qenë shënuar edhe numri i tij i telefonit. Në kushtet e mosmarrjes së njoftimit, gjykata e apelit kishte detyrimin të zbatonte dispozitat procedurale për njoftimin e tij me shpallje, çka nuk është bërë.

6.2.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij.

6.2.2.1 Gjykata e apelit ka arsyetuar vetëm për disa nga shkaqet e ankimit, ndërsa një prej shkaqeve për të cilat ajo arsyeton nuk është ngritur prej tij. Konkretisht, ai nuk ka vënë në diskutim veprimet e të birit në aeroport, pasi ka ardhur nga Gjermania. Ndërkohë, kjo gjykatë nuk ka arsyetuar se pse ka vlerësuar të drejtë vendimin e prokurorisë. Arsyetimi i vendimit të saj përmbledhet në 3 rreshta.

6.2.2.2 Vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar. Kjo gjykatë e ka vlerësuar të parëndësishëm mosnjoftimin e tij për gjykimin e



çështjes në gjykatën e apelit, me arsyetimin se gjykimi zhvillohet në dhomën e këshillimit dhe se pretendimet e tij janë parashtruar në ankim. KPP-ja nuk përmban asnjë dispozitë që përcakton se palët nuk njoftohen për gjykimet në apel në dhomën e këshillimit. Po kështu, ajo ka arsyetuar se vendimi unifikues i saj nr. 2, datë 20.6.2013, nuk merret në konsideratë kur gjykata e apelit gjykon në dhomën e këshillimit, ndërkohë që zbatimi i vendimeve unifikuese përbën detyrim ligjor. Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në lidhje me pretendimet e tij për vendimin e gjykatës së rrethit, dhe se gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim. Pavarësisht shkaqeve të ngritura për shkelje të rënda procedurale me pavlefshmëri të vendimit, siç është mosnjoftimi i tij, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPP-së.

7. *Subjekti i interesuar*, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar:

7.1 Kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit, sipas përcaktimit të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 3.7.2023, ndërsa sipas shënimit në kopjen e vendimit rezulton se ai është tërhequr nga kërkuesi në datën 14.12.2023. Një shënim i tillë nuk vërteton datën e marrjes dijeni efektivisht nga kërkuesi për këtë vendim.

7.2 Pretendimet e kërkuesit për cenimin e *së drejtës së jetës* së djalit të tij janë të pabazuara, pasi nga ana e organit të prokurorisë janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme në drejtim të garantimit të kësaj të drejte. Për sa i përket aspektit substancial të kësaj të drejte, strukturat policore nuk kishin dijeni se viktimat kishin probleme të shëndetit mendor që do ta çonin në vetëvrasje, çka do të sillte detyrimin pozitiv për marrjen e masave parandaluese. Në momentin e konstatimit të rrezikut, reagimi i këtyre strukturave ka qenë në përputhje me situatën. Po kështu, ka rezultuar e provuar se nuk bëhej fjalë për kryerjen ose moskryerjen me dashje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, të tilla që përbëjnë mospërmbyllje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike, sipas nenit 248 të KP-së. Në aspektin procedural është bërë regjistrimi i veprës penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, është ekzaminuar vendi i ngjarjes, janë marrë prova, është ekzaminuar trupi i të ndjerit, është ndërtuar itinerari i mundshëm i lëvizjeve të tij, janë ekzaminuar sendet

e tij personale dhe mënyra se si janë gjetur, janë marrë pamje fotografike dhe filmike, janë pyetur dëshmitarë, është pyetur personeli i trupës policore dhe i ruajtjes së aeroportit, janë analizuar veprimet e tyre, si dhe është marrë informacion për ta nga strukturat përkatëse. Në përfundim të hetimeve është arritur në konkluzionin se ngjarja ka ndodhur si rezultat i veprimeve të kryera nga viktimat.

7.3 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit*, si rrjedhojë e mosnjoftimit të tij për datën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Apelit Tiranë, është i bazuar. Pavarësisht se sipas nenit 329, pika 7, të KPP-së ankimi ndaj vendimit të prokurorisë për pushimin e çështjes shqyrtohet nga gjykata e apelit në dhomën e këshillimit, me qëllim garantimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, kjo gjykatë duhej të sigurohej që kërkuesi kishte marrë dijeni për datën e zhvillimit të gjykimin.

7.4 Pretendimet e kërkuesit për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi si prokuroria, ashtu edhe gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë shteruese për pretendimet e tij, duke konkluduar se hetimet kanë qenë të plota dhe vërtetojnë jo vetëm mungesën e elementeve të veprës penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, por edhe të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, si vepra të mundshme që kanë përcaktuar kuadrin e hetimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.



9. Në jurisprudencën e saj për çështje të mbrojtjes së të drejtës së jetës, të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Gjykata ka legjitimuar në paraqitjen e ankimit kushtetues individual familjarët e afërm të viktimës, për shkak të interesit të tyre të drejtpërdrejtë në çështje të kësaj natyre (shih vendimin nr. 42, datë 29.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret Gjykata vëren se kërkuksi është babai i viktimës, J. K. Si familjar i afërm i këtij të fundit, ai legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P”, të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës “I”, të pikës 1, të nenit 134, të Kushtetutës, pasi ka interes në çështjen e parashtruar si viktimë jo e drejtpërdrejtë e shkeljeve të pretenduara gjatë procesit gjyqësor në lidhje me vendimin e Prokurorisë së Tiranës për pushimin e procedimit penal.

10. Gjykata çmon se kërkuksi ka plotësuar edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, ndaj nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

12. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me

një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (shih vendimet nr. 36, datë 30.4.2024; nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese).

13. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuksi ka kundërshtuar pushimin e procedimit penal nga Prokuroria e Tiranës, për të cilin është ankuar edhe në gjykatat e zakonshme, proces i cili ka përfunduar me vendimin nr. 00-2023-1151, datë 3.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërsa ankimi kushtetues individual është depozituar në datën 20.12.2023. Sipas informacionit të vënë në dispozicion të Gjykatës me shkresën nr. 240/1 prot., datë 22.1.2024, të kancelarit të Gjykatës së Lartë, rezulton se vendimi i kundërshtuar i kësaj të fundit është bërë i disponueshëm për palët në datën 25.9.2023. Në këto kushte, në përgjigje edhe të prapësimit të ngritur në këtë drejtim nga Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata çmon se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

14. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, në ankimin kushtetues individual kërkuksi ka pretenduar cenimin e së drejtës së jetës, si dhe të së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit e të standardit të arsytimit të vendimit, pretendime të cilat, *prima facie*, përfshihen në juridiksionin kushtetues. Duke pasur parasysh thelbin e tyre, Gjykata vlerëson t'i trajtojë ato së bashku në drejtim të së drejtës së jetës, të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së. Po kështu, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuksit në lidhje me këtë të drejtë ngrihen si në kuadër të aspektit substancial të saj, për shkak të mosndërmarrjes nga ana e autoriteteve shtetërore të veprimeve për garantimin e së drejtës së jetës së të birit e mospërcaktimit të saktë të veprës penale të kryer, ashtu edhe në kuadër të aspektit procedural, si rrjedhojë e moskryerjes së hetimeve efektive për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes dhe mosnjoftimit të tij për gjykimin në gjykatën e apelit. Në kushtet kur e drejta e jetës në aspektin substancial qëndron e pavarur nga aspekti procedural i saj, në vijim Gjykata çmon t'i analizojë pretendimet e kërkuksit për cenimin e kësaj të drejte në të dyja këto aspekte.

*B. Për themelin e pretendimeve**B.1 Për cenimin e së drejtës së jetës**B.1.1 Për aspektin substancial*

15. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së të birit për jetën, për shkak se nga momenti i ngjitjes së të birit sipër zyrave të kompanive ajrore në brendësi të aeroportit dhe deri në momentin e hedhjes së tij, Policia e Shtetit dhe punonjësit e sigurisë nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për parandalimin e ngjarjes ose që pasojat të ishin më të lehta. Sipas tij, organi i prokurorisë ka hetuar për kryerjen e veprës penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, ndërkohë që në rastin konkret nuk bëhet fjalë për këtë veprë penale, sipas përcaktimit të KP-së, por për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i këtij kodi, me pasojë vdekjen e personit. Pretendimeve të tij në këtë drejtim nuk u është dhënë përgjigje as nga gjykatat.

16. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së jetës së djalit të tij janë të pabazuara, pasi nga ana e organit të prokurorisë janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme në drejtim të garantimit të kësaj të drejte. Strukturat policore nuk kishin dijeni se viktima kishte probleme të shëndetit mendor që do ta çonin në vetëvrasje, çka do të sillte detyrimin e tyre pozitiv për marrjen e masave parandaluese. Në momentin e konstatimit të rrezikut, reagimi i këtyre strukturave ka qenë në përputhje me situatën. Po kështu, ka rezultuar e provuar se nuk bëhej fjalë për kryerjen ose moskryerjen me dashje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, të tilla që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike, sipas nenit 248 të KP-së. Si prokuroria, ashtu edhe gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë shteruese për pretendimet e kërkuesit, duke konkluduar se hetimet kanë qenë të plota dhe vërtetojnë jo vetëm mungesën e elementeve të veprës penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, por edhe të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”.

17. Neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e personit mbrohet me ligj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kjo e drejtë qëndron në themel të të gjitha të drejtave dhe mohimi i saj sjell edhe eliminimin e të drejtave të tjera njerëzore. Sipas Gjykatës, jeta njerëzore, duke u konsideruar e tillë që nga fillimi i saj, bëhet një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera që mbrohet nga Kushtetuta. Ky është edhe qëllimi i Kushtetutës sonë, i cili del që në

Preambulën e saj, si dhe në mjaft dispozita të tjera (*shih vendimet nr. 42, datë 29.5.2024; nr. 65, datë 10.12.1999, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), neni 2 i KEDNJ-së vendos mbi shtetet detyrimin për marrjen e masave operacionale për mbrojtjen e individit jo vetëm nga persona të tjerë, por edhe nga vetvetja dhe mosmarrja prej tyre e masave, brenda pushtetit që organet ligjzbatuese ushtrojnë për shmangien e një rreziku të tillë, kur ato kanë dijeni ose duhet të kenë dijeni për kryerjen e vetëvrasjes, cenon nenin 2 të KEDNJ-së (*shih Vasilca kundër Republikës së Moldavisë, datë 11.2.2014, § 28; Mikayil Mammadov kundër Azerbajxhanit, datë 17.12.2009, §§ 99 dhe 116*).

19. Po sipas GJEDNJ-së, në situata ku individit kërcënon të marrë jetën e tij në prani të përfaqësuesve të autoriteteve ligjzbatuese, këto të fundit duhet të trajtojnë një kërcënim të tillë me seriozitetin më të madh, si një rrezik imediat për jetën e individit, pavarësisht se sa i papritur mund të jetë kërcënimi. Detyrimi pozitiv i përcaktuar në nenin 2 të KEDNJ-së kërkon ndërmarrjen e masave për të parandaluar materializimin e kërcënimit përmes mjeteve të arsyeshme dhe të mundshme në varësi të rrethanave (*shih Mikayil Mammadov kundër Azerbajxhanit, datë 17.12.2009, §§ 111 dhe 115*). Megjithatë, duke pasur parasysh vështirësitë e qenësishme në policimin e shoqërisë, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operacionale që duhen bërë në drejtim të prioriteteve dhe burimeve, objekti i detyrimit pozitiv për të marrë masa operacionale dhe parandaluese duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk vendos barrë të pamundur dhe disproporcionale mbi autoritetet. Në këtë kuptim, jo çdo pretendim për cenimin e së drejtës së jetës kërkon marrje të masave operacionale për parandalimin e materializimit të rrezikut të vetëvrasjes (*shih Renolde kundër Francës, datë 16.8.2008, § 81*).

20. Nën dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata çmon të vlerësojë nëse aeroporti “Nënë Tereza” përfshihet në zonat ku ruajtja e rendit dhe sigurisë i nënshtrohen mbikëqyrjes së posaçme të organeve ligjzbatuese dhe nëse këto organe kishin mundësi të parashikonin ardhjen e pasojës, me qëllim marrjen e masave parandaluese për shmangien e saj, pra nëse në rastin e kërkuesit plotësohen kriteret e paparashikueshmërisë dhe parandalimit të pasojës, si detyrime që rrjedhin në



kuadër të garantimit të aspektit substancial të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së.

21. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në datën kur ka ndodhur ngjarja, çështjet e sigurimit dhe sigurisë së aeroportit “Nënë Tereza”, Rinas rregulloheshin përmes marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “Tirana Airport Partners” sh.p.k. “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare”, të miratuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004. Sipas kësaj marrëveshjeje, shoqëria koncesionare do të jetë përgjegjëse për sigurinë në zonën e koncesionit, ku përfshihet rrua rrethuese e aeroportit dhe perimetri i rrethimit të sigurisë së aeroportit, në varësi të konfirmimit me shkrim nga organi shtetëror i autorizuar (*Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit në kohën e lidhjes së marrëveshjes*). Mbi bazën e këtij konfirmimi dhe sipas përcaktimeve në shtojcat e marrëveshjes koncesionare, në përputhje me procedurat dhe funksionet e saj, të cilat në kuadër të ruajtjes dhe sigurisë së aeroportit janë përcaktuar në shtojcën 44 të marrëveshjes, shoqëria garanton, ndër të tjera, edhe sistemin e administrimit të ruajtjes së aeroportit.

22. Po kështu, shoqërisë i është njohur e drejta për të nënkontraktuar kryerjen e veprimeve të sigurimit dhe/ose të sigurisë në zonën e koncesionit, në përputhje me kontratën dhe ligjin e zbatueshëm shqiptar. Staf i angazhuar në veprimtaritë e sigurisë dhe sigurimit, si dhe stafi i angazhuar në operacione në anën e aerodromit është objekt i procedurave të posaçme të rekrutimit, të cilat kryhen në përputhje me ligjin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë dhe konventat (*pika 12*). Nga ana tjetër, sistemi i administrimit të sigurisë në aeroport, i cili duhet të jetë në përputhje me Dok. 9774 të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil në lidhje me Manualin e Certifikimit të Aerodromeve, rishikohet vit për vit dhe përditësohet nga shoqëria për të siguruar përmbushjen e standardeve dhe praktikave kombëtare e ndërkombëtare (*shtojca 39*).

23. Në jurisprudencën e saj GJEDNJ-ja ka theksuar se dhënia me koncesion e menaxhimit të shërbimeve publike palëve të treta nuk shmanget detyrimin e shtetit për të garantuar të drejtat e parashikuara nga KEDNJ-ja (*shih Di Sarno dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 10.1.2021, § 110*). Në këndvështrim

të kësaj jurisprudence, si dhe kuadrit ligjor në fuqi, Gjykata vëren se aeroporti “Nënë Tereza” përbën një zonë ku organet ligjzbatuese (punonjësit e sigurisë private të aeroportit, sipas marrëveshjes së koncesionit) ushtrojnë mbikëqyrje të veçantë në drejtim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë, çka kërkon përmbushjen nga shteti të detyrimeve pozitive në kuadër të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së.

24. Duke pasur parasysh karakteristikat e rastit konkret, si dhe faktin se ngjarja ka ndodhur në ambientet e brendshme të aeroportit, ku përgjegjësia për sigurinë dhe mbrojtjen e të cilit, sipas legjislacionit në fuqi, i përkiste autoriteteve ligjzbatuese private, Gjykata çmon të analizojë veprimet e ndërmarra nga autoritetet e sigurisë së aeroportit në kuadër të garantimit të së drejtës së të birit të kërkuarit në aspektin substancial.

25. Nga materialet e dosjes gjyqësore të tërhequr për qëllime të gjykimit kushtetues të çështjes, Gjykata vëren se sipas procesverbaleve të marrjes në pyetje të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të shërbimit të sigurisë private të aeroportit, I. M., S. S., V. K., E. Q., Gj. K. dhe Sh. H., në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale, rezulton se shtetasi J. K., i biri i kërkuarit, pasi është kthyer nga udhëtimi me avion në shtetin e Gjermanisë, është ngjitur përmes një shkalle të brendshme anësore mbi zyrat e kompanive ajrore të terminalit të aeroportit, ku dhe është pikasur nga punonjësit e Policisë së Shtetit e të shërbimit të sigurisë private të aeroportit, të cilët janë afruar menjëherë në vendngjarje. Në kushtet kur vendi se nga ku J. K. është ngjitur nuk ka qenë i sigurt, ata i kanë kërkuar të qëndronte gjakftohtë, të mos bënte veprime të nxituara dhe se do ta ndihmonin për çdo gjë që kishte nevojë. Po sipas këtyre procesverbaleve, rezulton se kohëzgjatja e bisedës me J. K. deri në momentin kur ai është hedhur ka qenë pak minuta. Menjëherë pas hedhjes, J. K. është dërguar me urgjencë në spital nga shërbimi mjekësor i aeroportit. Po kështu, sipas procesverbalit të marrjes në pyetje të motrës së viktimës, rezulton se J. K. nuk kishte probleme të shëndetit mendor, por ishte tip i mbyllur me familjen dhe me shoqërinë.

26. Në lidhje me ngjarjen Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se nuk rezultonte që persona konkretë, me veprime ose mosveprime të drejtpërdrejta, me dashje të tërthortë ose nga pakujdesia, të kenë shkaktuar ardhjen e pasojës,



hedhjen nga lartësia të shtetasit J. K., dhe më pas vdekjen e tij (*shih faqen 6, të vendimit nr. 1195 akti, datë 15.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*). Ky vendim është vlerësuar i drejtë dhe i bazuar në ligjin material e procedural nga Gjykata e Apelit Tiranë. Edhe sipas kësaj gjykate, nga materialet e çështjes ka rezultuar e provuar plotësisht se nuk bëhej fjalë për kryerje ose moskryerje me dashje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbënin mospërbushje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike, në kuptim të nenit 248 të KP-së (*shih faqet 7 dhe 9, të vendimit nr. 183, datë 1.2.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Ligjshmëria e vendim-marrjeve të këtyre gjykatave është kontrolluar në vijim nga Gjykata e Lartë, e cila i ka vlerësuar ato të drejta, pasi nga qëndrimi i mbajtur dhe arsyetimi i vendimeve të gjykatave më të ulëta nuk rezultojnë elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” nga ana e punonjësve të aeroportit “Nënë Tereza” (*shih faqen 9, paragrafi 8, të vendimit nr. 00-2023-1151, datë 3.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

27. Në analizë të vendimeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se, ndryshe nga sa kërkuesi pretendon, në përbushje të detyrimeve pozitive që neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së vendosin ndaj shtetit, autoritetet ligjzbatuese kanë marrë masa për garantimin e aspektit substancial të së drejtës së jetës së djalit të kërkuesit. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në rastin konkret nuk evidentohet se punonjësit e sigurisë private të aeroportit mund të parashikojnë qëllimet e J. K. pas hipjes së tij sipër zyrave të kompanisë ajrore të aeroportit, ndaj nuk mund të përcaktojnë rrezikun real e të menjëhershëm që i shkaktohej jetës së tij. Sapo ky rrezik është bërë evident, rezultojnë se autoritetet e sigurisë së aeroportit kanë ndërmarrë masa operationale për të parandaluar ardhjen e pasojës. Kështu, me të marrë njoftimin, ata janë paraqitur menjëherë në vendngjarje, janë përpjekur të hyjnë në bisedime me J.K. dhe pas hedhjes së tij e kanë dërguar me urgjencë në spital. Në këtë këndvështrim, nga ana e punonjësve të policisë private të aeroportit nuk rezultojnë veprime ose mosveprime të kryera në kundërshtim me detyrimet që neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së vendosin në lidhje me situatat kur një individ kërcënon të vetëvritet në sy ose në prani të tyre dhe nuk rezultojnë që ata të kenë shfaqur neglizhencë në drejtim të garantimit të së drejtës së J. K. për jetën.

28. Po kështu, Gjykata çmon se gjykatat e zakonshme kanë argumentuar mjaftueshëm qëndrimet e mbajtura në vendimet e tyre në kuadër të aspektit substancial të kësaj të drejte, ndaj vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e nenit 21 të Kushtetutës, si rrjedhojë e mosmarrjes nga forcat e sigurisë dhe sigurimit të aeroportit të masave për shmangien e vetëvrasjes së të birit, janë të pabazuara.

29. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk rezultojnë shkelje të aspektit substancial të nenit 21 të Kushtetutës nga autoritetet ligjzbatuese që operonin për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë së aeroportit “Nënë Tereza”.

B.1.2 Për aspektin procedural

B.1.2.1 Për kryerjen e betimeve efektive për zbulimin e rrethanave të ngjarjes

30. Kërkuesi ka pretenduar se Prokuroria e Tiranës nuk ka kryer hetime efektive për zbulimin e rrethanave të ngjarjes ku ka gjetur vdekjen e biri. Ai ka kërkuar nga kjo prokurori kryerjen e një sërë veprimeve shtesë, kërkesa të cilat nuk janë marrë parasysh dhe pretendimet e tij në këtë drejtim nuk janë marrë parasysh as nga gjykatat.

31. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se nga ana e Prokurorisë së Tiranës është bërë regjistrimi i veprës penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, si dhe janë kryer hetimet e nevojshme për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, në përfundim të të cilave është arritur në konkluzionin se ngjarja ka ndodhur si rezultat i veprimeve të kryera nga viktimat.

32. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të përcaktojë faktet dhe fajësinë e autorëve të veprës penale dhe as të interpretojë ligjin penal, detyrë e cila i përket prokurorisë dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh edhe parimin e subsidiaritetit, për të vlerësuar respektimin e së drejtës kushtetuese të jetës, Gjykata analizon nëse hetimet nga organi i ndjekjes penale kanë qenë efektive, pra nëse ato kanë qenë të përshtatshme, të plota, të paanshme, të kujdesshme dhe kanë ndjekur një linjë të qartë në funksion të zbulimit të rrethanave të ngjarjes dhe identifikimit të autorëve të saj (*shih vendimin nr. 42, datë 29.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë nëse këto standarde përmbushen në çështjen në shqyrtim.

33. Në rastin konkret, në kuadër të masave për garantimin e aspektit procedural të nenit 21 të



Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se në lidhje me ngjarjen Prokuroria e Tiranës ka regjistruar procedimin penal nr. 8543, të vitit 2016, për veprën penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, të parashikuar nga neni 99 i KP-së. Sipas këtij neni: *“Shkaktimi i vetëvrasjes ose i tentativës së vetëvrasjes së një personi, si rrjedhojë e trajtimit të keq sistematik ose nga sjellje të tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin, të kryera nga personi që e ka në varësi apo nga personi me të cilin ka marrëdhënie familjare ose bashkëjetese, dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet.”*. Po kështu, për qëllime të zbardhjes së rrethanave të ngjarjes, nga ana e organit të prokurorisë janë kryer veprime hetimore të tilla, si: këqyrja e vendit të ngjarjes përmes fotografimit të ambienteve të terminalit, këqyrja e kufomës, pyetja e punonjësve të Policisë së Shtetit I. M. dhe S. S., pyetja e punonjësve të kompanisë private ICTS Albania V. K., E. Q., Gj. K. dhe Sh. H., pyetja në datat 3.9.2016 dhe 24.2.2017, e motrës së viktimës, shtetases L. K., kryerja e ekspertimit mjekoligjor të viktimës, kryerja e ekspertimit biologjik të gjakut të viktimës, ekspertimi teknik i pamjeve filmike të momentit të ngjarjes dhe kontrolli i çantës së viktimës. Në përfundim të vlerësimit të fakteve dhe provave, Prokuroria e Tiranës ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke vlerësuar se nuk plotësoheshin elementet e figurës penale të parashikuar nga neni 99 i KP-së.

34. Në kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për pushimin e çështjes, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se organi i ndjekjes penale nuk kishte kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, pasi nuk kishte hetuar për masat e sigurisë së aeroportit, në kushtet kur edhe nga eksperti kishte deklaruar se nuk mund të përcaktohej nëse veprimet e personelit dhe policisë së aeroportit ishin në përputhje me detyrat e tyre funksionale; nuk kishte hetuar në lidhje me personat me të cilët kërkuesi kishte udhëtuar në avion gjatë kthimit nga shteti gjerman; akti i ekspertimit ishte bazuar vetëm në kamerën nr. 13 të aeroportit, ndërkohë që në ambientet e aeroportit kishte dhe shumë kamera të tjera që mund të paraqisnin fushëpamje të ndryshme; si dhe nuk ishte hetuar mbi masat e sigurisë teknike të portës përmes së cilës viktima ishte ngjitur në tarracë.

35. Në lidhje me pretendimet e kërkuetit, në vendimin për çështjen Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka konstatuar se për qëllime të hetimit penal Prokuroria e Tiranës ka kryer një sërë veprimesh procedurale, të tilla si: këqyrja e vendit të ngjarjes e shoqëruar me tabelë fotografike; këqyrja e viktimës; pyetja e personave që kanë dijeni për rrethana të hetimit; kryerja e ekspertimit mjeko-ligjor; kryerja e ekspertimit biologjik; kontrolli i valixhes së udhëtimit të viktimës; ekspertimi teknik-sinjalistik i CD-së me pamjet filmike të ngjarjes; marrja e informacionit nga Drejtoria e Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave nëse në ngjarje janë implikuar punonjës së policisë, si dhe nga Komisariati i Policisë për Kufirin dhe Migracionin, aeroporti “Nënë Tereza”, nëse vendi nga ku është ngjitur viktima ruhej me personel të posaçëm sigurisë. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, gjykata ka vlerësuar të drejtë vendimin e prokurorisë për pushimin e procedimit penal, me argumentin se nga ana e prokurorisë janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në lidhje me ngjarjen dhe se në vendimin e këtij organi për pushimin e çështjes janë dhënë përgjigje, duke sqaruar me detaje veprimet ose mosveprimet e kryera. Hetimi ka qenë i plotë e i gjithanshëm dhe organi i prokurorisë ka vepruar në konformitet të plotë me ligjin (*shih faqet 7–9, të vendimit nr. 1195 akti, datë 15.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

36. Në ankimin ndaj vendimit të gjykatës së rrethit, krahas pretendimeve të ngritura në kërkesën drejtuar kësaj gjykate, kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se nga ana e prokurorisë duhej të kryheshin hetime më të thelluara për të përcaktuar nëse pasoja ka ardhur si rezultat i kryerjes së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së.

37. Gjykata e Apelit Tiranë ka vlerësuar se nga ana e prokurorisë janë kryer hetime të gjithanshme dhe vendimi është marrë në përfundim të rezultateve të hetimit. Sipas saj, në rastin konkret ekzistonte një nga shkaqet e përcaktuara në nenin 328 të KPP-së për pushimin e akuzës dhe gjykata e rrethit kishte arsyetuar në mënyrë të plotë në lidhje me vendimin e prokurorisë. Për sa u përket pretendimeve të kërkuetit për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, gjykata e apelit ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ndodhej



përpara kryerjes ose moskryerjes me dashje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbënin mospërbushje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike. Për rrjedhojë, vendimi i gjykatës së rrethit ishte i drejtë dhe duhej të lihej në fuqi (*shih faqet 8–9 të vendimit nr. 183, datë 1.2.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

38. Krahës pretendimeve të ngritura në gjykatën e rrethit dhe atë të apelit në lidhje me moskryerjen e hetimeve të gjithanshme nga ana e prokurorisë, në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuar ka paraqitur edhe dy pretendime: i. Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka bërë njoftimin e tij me shpallje për datën dhe orën e gjykimit të çështjes; ii. cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për shkak se vendimet e gjykatës së rrethit dhe të apelit ishin të paarsyetuara.

39. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se asnjë prej pretendimeve të kërkuar nuk u referohej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas kësaj gjykate, pretendimet e tij në lidhje me hetimet e kryera nga prokuroria ishin marrë në shqyrtim nga gjykatat më të ulëta, të cilat kishin dhënë përgjigje të arsyetuar në lidhje me to, duke vlerësuar se pretendimet për hetime shtesë ishin të pabazuara, pasi organi i akuzës kishte kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe nga hetimi kishte rezultuar se fakti nuk përbënte vepër penale. Po kështu, edhe pretendimi i kërkuar se prokuroria nuk kishte hetuar në drejtim të kryerjes së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” nga ana e punonjësve të aeroportit nuk ishte i bazuar, pasi nga vendimet e gjykatave rezultonte se nuk ekzistonin elemente të kësaj vepre penale (*shih faqet 9, paragrafët 17–18, të vendimit nr. 00-2023-1151, datë 3.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

40. Në lidhje me pretendimin për mungesën e njoftimit për gjykimin në apel, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se përmes fletëthirrjes kërkuar është njoftuar në adresën e lënë prej tij për gjykimin e çështjes nga gjykata e apelit në dhomë këshillimi. Ndonëse njoftimi është kthyer nga posta me shënimin “Adresë e pasaktë”, ai ka pasur pritshmëri për datën dhe orën e gjykimit të çështjes, pasi sipas nenit 329, pika 7, të KPP-së ankimi ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal shqyrtohet nga gjykata e apelit në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga data e marrjes së

akteve. Po kështu, ankimi ndaj vendimit të gjykatës së rrethit është ushtruar nga kërkuar, duke iu dhënë mundësia të paraqesë pretendimet e tij (*shih faqet 9–10, paragrafi 19, të vendimit nr. 00-2023-1151, datë 3.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

41. Për sa u përket pretendimeve të kërkuar për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata e rrethit dhe ajo e apelit, Gjykata e Lartë i ka gjetur ato të pabazuara, pasi, në kundërshtim nga sa kërkuar pretendonte, gjykatat kishin dhënë përgjigje për pretendimet e ngritura prej tij (*shih faqet 10–11, paragrafët 24–25, të vendimit nr. 00-2023-1151, datë 3.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

42. Në analizë të masave të ndërmarra nga organi i ndjekjes penale për qëllime të përbushjes së detyrimeve që përcakton aspekti procedural i nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së, vendimit të këtij organi për pushimin e procedimit penal, si dhe vendimeve të gjykatave të zakonshme, Gjykata vlerëson se, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja për qëllime të garantimit të aspektit procedural të së drejtës së jetës së J. K., qasja e mbajtur nga organi i prokurorisë nuk rezultoi të mos ketë pasur një linjë të qartë hetimi në lidhje me ngjarjen për qëllime të përcaktimit të shkaqeve që kanë çuar J. K. në vetëvrasje dhe procesi hetimor, në tërësinë e tij, nuk rezultoi në cenim të garancive procedurale që parashikojnë neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së. Organi i ndjekjes penale ka vendosur pushimin e procedimit penal, për shkak se nuk ka rezultuar që persona konkretë, me veprime ose mosveprime të drejtpërdrejta, me dashje të tërthortë ose nga pakujdesia të kenë shkaktuar ose lejuar, në kundërshtim me detyrën, ardhjen e pasojës, hedhjen nga lartësia të shtetasit J. K.

43. Po kështu, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuar në këtë drejtim janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, të cilat i kanë analizuar ato përkundrejt veprimeve të ndërmarra nga organi i ndjekjes penale, duke dhënë përgjigje të arsyetuar për qëndrimet e mbajtura prej tyre. Në kuadër të këtij vlerësimi, Gjykata çmon se nuk qëndrojnë as pretendimet e kërkuar për shkeljet procedurale në gjykimin në shkallë të dytë lidhur me njoftimin. Realizimi i njoftimit nuk përbën qëllim në vetvete, por shërben si garanci për



ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes, si dhe është në funksion të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Në kushtet kur ankimi ndaj vendimit të gjykatës së rrethit është ushtruar nga kërkuesi, në të cilin ka parashtruar pretendimet e tij, si dhe nuk rezulton të jenë paraqitur prapësime në lidhje me të nga ana e prokurorisë, Gjykata çmon se moskryerja e njoftimit me shpallje për datën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit nuk e ka vënë kërkuesin në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat e tij ose në kushte të pabarabarta me organin e ndjekjes penale. Për më tepër, parashikimet e KPP-së përcaktojnë qartë afatin ligjor brenda të cilit gjykata ka detyrimin për marrjen në shqyrtim të ankimit.

44. Në vlerësim tërësor të rrethanave dhe fakteve, Gjykata arrin në përfundimin se qëndrimet e këtyre gjykatave nuk rezultojnë në cenim të parashikimeve kushtetuese dhe konventore që garantojnë të drejtën e jetës në aspektin procedural.

45. Në kushtet kur, për sa më lart, Gjykata çmoi se prokuroria dhe gjykatat kanë vepruar në përputhje me detyrimet që përcaktojnë Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së jetës së të birit, për shkak të mungesës së hetimeve të plota dhe efektive nga organet e ndjekjes penale, është i pabazuar.

46. Në përmbledhje të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së jetës në aspektin substancial, si rrjedhojë e mosmarrjes nga autoritetet ligjzbatuese të veprimeve për garantimin e së drejtës së jetës së të birit dhe mospërcaktimit të saktë të veprës penale të kryer, si dhe në aspektin procedural, si rrjedhojë e moskryerjes së hetimeve efektive për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes dhe mosnjoftimit të tij për datën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, janë të pabazuara.

47. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa nuk është e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj dhe nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të

ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 20.6.2024.

Shpallur, më 19.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj (kundër)

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Elsa Toska, Marjana Semini

Anëtar kundër: Sonila Bejtja, Genti Ibrahim

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Shaban Kapllanaj, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë vendosur rrëzimin e ankimeve të tij ndaj vendimit të Prokurorisë së Tiranës për pushimin e procedimit penal të nisur në lidhje me ngjarjen ku ka gjetur vdekjen i biri, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë që ajo duhej të ishte pranuar, për shkak se pretendimet e kërkuesit ishin të bazuara. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. E drejta e çdo personi për jetën garantohej nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2, pika 1, i KEDNJ-së. Në jurisprudencën e saj në lidhje me këtë të drejtë Gjykata ka theksuar se jeta njerëzore, duke u konsideruar e tillë që nga fillimi i saj, bëhet një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera që mbrohet nga Kushtetuta. Ky është edhe qëllimi i Kushtetutës sonë, i cili del që në Preambulën e saj, si dhe në mjaft dispozita të tjera (*shih vendimet nr. 42, datë 29.5.2024; nr. 65, datë 10.12.1999, të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Ashtu si edhe shumica ka vënë në dukje në vendim, si dhe siç është elaboruar gjerësisht nga GJEDNJ-ja, kjo e drejtë përmban dy aspekte, aspektin substancial, i cili kërkon marrjen e masave



nga autoritetet shtetërore për garantimin e saj, si dhe atë procedural, i cili kërkon kryerjen e hetimeve efektive për zbardhjen e rrethanave që çojnë në cenimin e kësaj të drejte, si dhe ndëshkimin e autorëve. Ndonëse jurisprudenca e Gjykatës nuk është e gjerë për sa i takon trajtimin të aspektit substancial të kësaj të drejte, theksojmë se ajo është elaboruar gjerësisht nga GJEDNJ-ja. Kështu, në kuadër të këtij aspekti, GJEDNJ-ja ka theksuar detyrimin e shtetit për marrjen e masave për miratimin e kuadrit të duhur ligjor dhe administrativ për parandalimin e kryerjes së krimeve kundër personit, e përforcuar kjo përmes ekzistencës së organeve ligjzbatuese që kanë si qëllim parandalimin, frenimin dhe ndëshkimin e cenimit të këtij neni të KEDNJ-së (*shih Makaratzis kundër Greqisë [DHM], datë 20.12.2004, § 57*).

4. Në lidhje me aspektin procedural, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se për qëllime të garantimit të së drejtës së jetës, organi i ndjekjes penale duhet të kryejë hetime efektive për zbulimin e rrethanave të ngjarjes dhe autorit të saj, të cilat duhet të jenë, ndër të tjera, të plota, të paanshme dhe të kujdesshme. Pavarësisht se nuk përbën detyrim për arritjen e rezultatit, por për përdorimin e mjeteve, çdo mangësi në hetim, e cila rrezikon përcaktimin e rrethanave të çështjes ose personin përgjegjës, cenon standardin e efektivitetit. Kjo do të thotë se ai duhet të jetë në gjendje të vërtetojë faktet dhe, sipas rastit, të arrijë të identifikojë dhe ndëshkojë përgjegjësit. Hetimi merr një rëndësi edhe më të madh kur rezultojnë vdekja e viktimës, duke pasur parasysh faktin se qëllimi thelbësor i një hetimi të tillë është të sigurojë zbatimin efektiv të ligjeve vendase që mbrojnë të drejtën për jetën (*shih vendimin nr. 42, datë 29.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në jurisprudencën e saj në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se për përcaktimin e shkaqeve që kanë çuar një individ në vetëvrasje, si dhe të personave përgjegjës, shtetet kanë detyrimin për marrjen e provave të nevojshme që hedhin dritë mbi faktet dhe rrethanat e ngjarjes, si dhe të analizimit të tyre në mënyrë objektive, pasi çdo mangësi në hetime për përcaktimin e këtyre shkaqeve rrezikon të jetë në kundërshtim me parashikimet e nenit 2 të KEDNJ-së (*shih S. P. kundër Zvicrës, datë 30.6.2020, §§ 116–121*). Për këtë qëllim, autoritetet hetimore duhet të veprojnë me nismë të tyre që në momentin që çështja u është

sjellë në vëmendje (*shih Boychenko kundër Rusisë, datë 12.10.2021, § 97*).

6. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së nuk imponojnë një detyrim për autoritetet hetuese për të përmbushur çdo kërkesë për veprime të caktuara hetimore të bërë nga një i afërm gjatë hetimit (*shih vendimin nr. 42, datë 29.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, sipas GJEDNJ-së, duke mbajtur parasysh edhe realitetin praktik të veprimtarisë hetimore, autoritetet duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për mbledhjen e menjëhershme të provave, me qëllim shmangien ose minimizimin e çdo rreziku që mosmarrja e tyre mund të shkaktojë në vendosjen përpara përgjegjësisë të personave përgjegjës. Një detyrim i tillë vazhdon të veprojë deri në momentin e qartësimit të natyrës së përgjegjësisë dhe autoritetet janë të bindura se nuk ka bazë për kryerjen ose vijimin e hetimit penal (*shih Boychenko kundër Rusisë, datë 12.10.2021, § 97*).

7. Po në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka theksuar se edhe mospërmendja e kërkesës së viktimës indirekte për marrjen e disa provave në vendimin e prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal dhe mosshqyrtimi prej këtij organi të provave të kërkuara nga viktimat përbën shkelje të detyrimit për hetime efektive, të parashikuar nga neni 2 i KEDNJ-së (*shih Vasilca kundër Republikës së Moldavisë, datë 11.2.2014, §§ 32–36*).

8. Në rastin konkret, në lidhje me garantimin e aspektit substancial të së drejtës së jetës së J.K., shumica, pasi ka analizuar parashikimet ligjore në lidhje me përgjegjësinë e autoriteteve ligjzbatuese të rendit dhe të sigurisë në aeroport, ka mbajtur qëndrimin se punonjësit e sigurisë private të aeroportit nuk mund të parashikonin qëllimet e të birit të kërkuesit pas hipjes së tij në pjesën sipër zyrave të kompanisë ajrore të aeroportit, ndaj nuk mund të përcaktonin rrezikun real e të menjëhershëm që i shkaktohej jetës së tij. Po sipas shumicës, autoritetet e sigurisë së aeroportit kanë ndërmarrë masa operationale për të parandaluar ardhjen e pasojës, ndaj veprimet ose mosveprimet e tyre nuk rezultojnë në kundërshtim me detyrimet që përcaktojnë neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së.

9. Në lidhje me aspektin procedural, shumica i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e kërkuesit për mungesën e hetimeve efektive për zbardhjen e



rrethanave të ngjarjes. Sipas shumicës, në rastin konkret, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, qasja e mbajtur nga organi i prokurorisë nuk rezultoi të mos ketë pasur një linjë të qartë hetimi për ngjarjen dhe pushimi i procedimit penal është vendosur për shkak se nuk ka rezultuar që persona konkretë, me veprime ose mosveprime të drejtpërdrejta, me dashje të tërthortë ose nga pakujdesia, të kenë shkaktuar ose lejuar, në kundërshtim me detyrën, ardhjen e pasojës. Po sipas shumicës, procesi hetimor, në tërësinë e tij, nuk rezultoi në cenim të garancive procedurale që parashikojnë neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së dhe pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, të cilat kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për qëndrimet e tyre.

10. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se hetimet e kryera nga organi i ndjekjes penale nuk kanë qenë efektive, të plota dhe të kujdesshme dhe nga ana e këtij organi nuk rezultoi të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes. Kështu, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjyqimit kushtetues të çështjes, rezultoi se në kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kundërshtimin e vendimit të prokurorisë lidhur me pushimin e çështjes, kërkuari ka pretenduar, ndër të tjera, se organi i akuzës nuk ka hetuar në lidhje me personat me të cilët kërkuari kishte udhëtuar në avion gjatë kthimit nga shteti gjerman, ndërsa e bija e kërkuarit dhe njëkohësisht motra e të ndjerit, e marrë në pyetje në cilësinë e personit që kishte dijeni për veprën penale, në lidhje me pyetjen nëse ajo ose familjarët e saj kishin dyshime të mundshme për arsyet që mund ta kenë shtyrë vëllain në vetëvrasje, ka deklaruar se ai komunikonte shpesh në telefon me një person, prej nga mund të dilte arsyeja e vërtetë e vetëvrasjes, ndërsa në lidhje me pyetjen nëse ka pasur probleme mjekësore gjatë jetës së tij, ka deklaruar se ai nuk kishte vuajtur nga ndonjë sëmundje, por ishte tip i mbyllur me familjen dhe shoqërinë.

11. Ashtu siç theksuam edhe më sipër, aspekti procedural i nenit 2 të KEDNJ-së kërkon marrjen e masave për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, me qëllim që hetimet të jenë të plota dhe efektive. Në rastin konkret, ndonëse organi i ndjekjes penale rezultoi të ketë marrë disa masa për zbulimin e rrethanave të ngjarjes, nuk rezultoi të ketë hetuar

për shkaqet ose faktorët që mund të kenë shtyrë të birin e kërkuarit në vetëvrasje, ndonëse qartazi rezultoi të jetë vënë në dijeni për mundësinë e ekzistencës së tyre nga motra e të ndjerit. Po kështu, nuk rezultoi të jenë pyetur në cilësinë e dëshmitarit familjarët e të ndjerit, me qëllim që të hidhej dritë mbi gjendjen psikologjike të tij përpara dhe pas ngjarjes; nuk rezultoi të jetë këqyruar telefoni i viktimës, pavarësisht se e motra ka bërë me dije që prej tij mund të rezultojnë fakte dhe rrethana në lidhje me ngjarjen; nuk rezultoi të jenë marrë nga kompanitë telefonike tabulatet e komunikimit të viktimës gjatë asaj periudhe; nuk rezultoi të jetë hetuar rreth gjendjes mendore të viktimës për shkaqet e largimit të saj për në Gjermani ose për personat me të cilët mund të jetë takuar atje. Për më tepër, nuk rezultoi të jenë bërë hetime në drejtim të përcaktimit nëse mund të kishte elemente të veprave të tjera penale. Në vendimin e Prokurorisë së Tiranës nuk rezultojnë argumente për mosmarrjen e veprimeve të tilla hetimore.

12. Në këndvështrim të sa më lart, pavarësisht se organi i akuzës nuk ka detyrimin për të marrë në konsideratë çdo kërkesë të të afërmeve të viktimës për kryerjen e veprimeve të caktuara hetimore, në kuadër të detyrimeve që vendos neni 2 i KEDNJ-së, në rastin konkret, vlerësojmë se nga ana e autoriteteve hetimore nuk rezultoi të jenë marrë të gjitha provat e nevojshme që do të hidhnin dritë mbi ngjarjen dhe në vendimin për pushimin e procedimit penal nuk rezultoi të jenë dhënë arsye për mosveprimin e tyre. Në këtë drejtim, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se verifikimi i tabulateve dhe i komunikimeve telefonike të të ndjerit përbënte një ndër veprimet bazë hetimore, që mund të kishte çuar edhe në zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, duke u përmbushur në këtë mënyrë detyrimi kushtetues që neni 21 i Kushtetutës vendos mbi organet e ndjekjes penale për kryerjen e hetimeve efektive, të plota dhe të përshtatshme. Për më tepër, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së (*shih paragrafin 7 më sipër*), në kushtet kur rëndësia e tabulateve dhe komunikimeve telefonike të të ndjerit ishte sjellë në vëmendje të organit të prokurorisë edhe nga motra e të ndjerit, ky organ kishte detyrimin t'i merrte ato në shqyrtim, duke arsyetuar qëndrimin e vet në lidhje me këto prova.

13. Në përfundim, vlerësojmë se për qëllime të garantimit të së drejtës për jetën të shtetasit J. K., organi i ndjekjes penale kishte detyrimin për marrjen



e të gjitha masave të nevojshme për zbulimit e shkaqeve ose faktorëve që kanë çuar në cenimin e kësaj të drejte, pasi çdo mangësi në hetim, në drejtim të përcaktimit të rrethanave të çështjes dhe personit përgjegjës, ka cenuar standardin e efektivitetit të hetimit penal. Në rastin në shqyrtim, çmujmë se qasja e mbajtur nga organi i prokurorisë nuk rezulton të ketë qenë shteruese në drejtim të pistave të hetimit në lidhje me ngjarjen, ndaj vlerësojmë se, në kundërshtim me detyrimet që përcaktojnë neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, hetimi i organit të ndjekjes penale nuk ka qenë i plotë dhe efektiv. Në këto kushte, në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se pretendimet e kërkuarit janë të bazuara, ndaj Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e kërkesës.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Genti Ibrahim, Sonila Bejtja

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Shaban Kapllanaj, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 1195 akti, datë 15.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 183, datë 1.2.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2023-1151, datë 3.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, ndonëse ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për zgjidhjen e kësaj çështjeje, nuk pajtohem me linjën e arsyetimit të bërë prej saj.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes, rezulton se kërkuari është babai i të ndjerit J. K., i cili ka ndërruar jetë në datën 1.9.2016, duke u hedhur nga një lartësi në mjediset e brendshme të aeroportit “Nënë Tereza”, Tiranë. Për ngjarjen e ndodhur, mbi bazën e materialeve të referuara nga Policia Gjyqësore e Komisarariatit të Policisë për Kufirin dhe Migracionin e aeroportit, Prokuroria e Tiranës ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”. Në përfundim të hetimeve, duke vlerësuar se nuk plotësoheshin elementet e veprës penale, organi i akuzës ka vendosur pushimin e procedimit penal. Vendimi i Prokurorisë së Tiranës është kundërshtuar gjyqësish nga kërkuari, i cili ka pretenduar cenimin e së drejtës së jetës së të birit, si rrjedhojë e mosmarrjes së masave nga autoritetet ligjzbatuese të aeroportit për garantimin e saj, si dhe moskryerjen e hetimeve

efektive nga ana e organit të ndjekjes penale për zbulimin e shkaqeve dhe rrethanave të ngjarjes. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në thelb, e kanë vlerësuar të drejtë vendimin e Prokurorisë së Tiranës për pushimin e procedimit penal. Në këto kushte, kërkuari i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

3. Shumica ka vlerësuar të shqyrtojë çështjen në drejtim të së drejtës së jetës në dy aspektet e saj, konkretisht aspektin substancial dhe atë procedural. Pas analizës së kuadrit ligjor në fuqi dhe qëndrimit të GJEDNJ-së, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, shumica, bazuar në vendimmarrjen e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih paragrafin 26 të vendimit*), ka vlerësuar se, për sa i takon aspektit substancial, organet e policisë private të aeroportit “Nënë Tereza”, të ngarkuara sipas ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004, “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare” me detyrimin për garantimin e rendit dhe të sigurisë në këtë aeroport, kanë marrë masa për mbrojtjen e së drejtës së jetës së shtetasit J. K., të birit të kërkuarit, dhe nuk rezultonte të kishin kryer veprime ose mosveprime në kundërshtim me detyrimet që përcaktojnë neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së (*shih paragrafin 27 të vendimit*).

4. Po sipas shumicës, edhe për sa i përket aspektit procedural të së drejtës së jetës, qasja e mbajtur nga organi i prokurorisë kishte pasur një linjë të qartë hetimi në lidhje me ngjarjen për qëllime të përcaktimit të shkaqeve që kishin çuar J. K. në vetëvrasje dhe procesi hetimor, në tërësinë e tij, nuk rezultonte në cenim të garancive procedurale që parashikojnë neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së. Organi i ndjekjes penale ka vendosur pushimin e procedimit penal, për shkak se nuk kishte rezultuar që persona konkretë, me veprime ose mosveprime të drejtpërdrejta, me dashje të tërthortë ose nga pakujdesia të kishin shkaktuar ose lejuar, në kundërshtim me detyrën, ardhjen e pasojës, hedhjen nga lartësia të shtetasit J. K. Në lidhje me mosnjohimin me shpallje të kërkuarit për gjykimin e çështjes nga Gjykata e Apelit Tiranë, shumica ka vlerësuar se, në kushtet kur ankimi ndaj vendimit të gjykatës së rrethit është ushtruar nga kërkuari, në të cilin ai ka parashtruar pretendimet e



tij, si dhe nuk janë paraqitur prapësime në lidhje me të nga ana e prokurorisë, moskryerja e njoftimit me shpallje për datën e gjyqimit të çështjes në gjykatën e apelit nuk e ka vënë kërkuesin në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat e tij ose në kushte të pabarabarta me organin e ndjekjes penale. Për më tepër, parashikimet e KPP-së përcaktojnë qartë afatin ligjor brenda të cilit gjykata ka detyrimin për marrjen në shqyrtim të ankimit (*shih paragrafët 42–43 të vendimit*).

5. Në parantezë, bashkohem me qëndrimin e shumicës së drejtës, e parashikuar në nenin 21 i Kushtetutës dhe nenin 2, pika 1, të KEDNJ-së, konsiderohet si një ndër vlerat themelore të mbrojtura nga Kushtetuta (*shih vendimet nr. 42, datë 29.5.2024; nr. 65, datë 10.12.1999, të Gjykatës Kushtetuese*) dhe në këtë kuptim shteti ka detyrimin për marrjen e masave për garantimin e kësaj të drejte substanciale. Megjithatë, sikurse jam shprehur edhe më parë (*shih mendimin e pakicës në vendimin nr. 53, datë 31.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*), mendoj se vlerësimi i të drejtave substanciale nuk duhet të shndërrohet në qëllim në vetvete dhe t'i hapë rrugë shqyrtimit të tyre në çdo rast, pasi përbën tejkalim të kufijve të shqyrtimit të çështjes jashtë objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të (*shih nenin 48, të ligjit nr. 8577/2000*).

6. Në vlerësimin tim, ndryshe nga shumica, çmoj se pretendimet e kërkuesit duhej të ishin trajtuar në drejtim të vlerësimit të cenimit të së drejtës së jetës të lidhur me të drejtën e procesit të rregullt ligjor, në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Në këtë kuptim duhej analizuar qëndrimi i mbajtur nga organet e përfshira në garantimin e së drejtës së jetës, në rastin konkret, Prokuroria e Tiranës dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ushtrim të funksioneve të tyre respektive për zbulimin e fakteve dhe rrethanave të ngjarjes, si dhe dhënies së drejtësisë.

7. Në mbështetje të qasjes sime, theksoj se në kërkesën drejtuar Gjykatës dhe në argumentet e parashtruara, kërkuesi, në cilësinë e viktimës indirekte, ka pretenduar cenimin e së drejtës së jetës së të birit, si rrjedhojë e vendimit të Prokurorisë së Tiranës për pushimin e procedimit penal dhe vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme që kanë rrëzuar ankimet e tij kundër vendimit të prokurorisë, pa bërë ndonjë diferencim për aspektin substancial dhe aspektin procedural të saj, siç ka zgjedhur të bëjë shumica. Me fjalë të tjera, pavarësisht se në thelb të

pretendimeve të kërkuesit është cenimi i së drejtës së jetës, argumentet e tij kanë të bëjnë me faktin se organi i ndjekjes penale nuk ka kryer hetime efektive në drejtim të zbardhjes së rrethanave të ngjarjes ku ka gjetur vdekjen i biri. Kërkuesi nuk ka pretenduar cenimin e së drejtës së jetës në mënyrë autonome dhe të pavarur nga procesi dhe aq më pak nuk e ka lidhur atë me faktin e vlerësuar nga shumica nëse aeroporti “Nënë Tereza” përfshihet në zonat ku ruajtja e rendit dhe sigurisë i nënshtrohen mbikëqyrjes së posaçme të organeve ligjzbatuese dhe nëse këto organe kishin mundësi të parashikonin ardhjen e pasojes, me qëllim marrjen e masave parandaluese për shmangien e saj (*shih paragrafin 20 të vendimit*). Për më tepër, edhe vetë shumica, në arritjen e përfundimeve të saj për aspektin substancial të së drejtës së jetës, i është referuar arsytimit të vendimeve gjyqësore (*shih paragrafin 26 të vendimit*).

8. Bazuar në këto konsiderata, ashtu siç edhe GJEDNJ-ja ka pranuar, procesi penal përfshin edhe fazën paragjykimore, konkretisht atë të hetimeve paraprake. Megjithatë, ajo çka paraqet rëndësi të veçantë për GJEDNJ-në është faza e shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimi nëse procesi në tërësinë e tij ka qenë i rregullt (*shih Helmers kundër Suedisë, nr. 11826/85, 29.10.1991, § 39; Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 13071/87, datë 16.12.1992, § 34; Dombo-Bebeer B. V. kundër Holandës, nr. 14448/88, datë 27.10.1993; Helle kundër Finlandës, nr. 157/1996/776/977, datë 19.12.1997, § 53*).

9. Po në të njëjtin drejtim, edhe në jurisprudencën e Gjykatës pretendimet e lidhura me fazën e hetimit penal janë marrë në shqyrtim në kontekst të procesit të rregull në tërësinë të tij, duke theksuar se kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ndodhen përpara pretendimeve dhe dyshimeve serioze faktike për veprime të paligjshme të organeve që procedojnë me ndjekjen penale, ato kanë detyrimin të ndërmarrin hapat e nevojshëm dhe të domosdoshëm për të kërkuar dhe sqaruar të gjitha rrethanat e çështjes (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 14, datë 3.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Për sa u takon provave dhe fakteve ku janë bazuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen në themel të çështjes së kërkuesit, jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se nuk është detyrë e Gjykatës t'i analizojë ato, pasi kjo mbetet detyrë funksionale e atyre gjykatave. Në aspektin e



kontrollit kushtetues, Gjykata shqyrton dhe vlerëson nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 31, datë 18.4.2024; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Duke mbajtur në vëmendje këto standarde, sikurse edhe shumica, vlerësoj se në rastin e kërkuarit, në analizë të fakteve dhe ligjit të zbatueshëm, gjykata e rrethit ka arsyetuar qëndrimin e saj për çështjen. Kështu, gjykata ka vlerësuar se nga ana e organit të ndjekjes penale ishin kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të tilla si: këqyrja e vendit të ngjarjes, e viktimës dhe e sendeve të kësaj të fundit; pyetja e personave që kishin dijeni për rrethanat e hetimit; kryerja e ekspertimeve mjekoligjore, teknikosinjalistike dhe biologjike; marrja nga autoritetet ligjzbatuese e informacioneve të nevojshme, për sa i përket ruajtjes së sigurisë në vendin ku është ngjitur i ndjeri. Po kështu, në vendimin e këtij organi për pushimin e çështjes është dhënë përgjigje e arsyetuar, duke sqaruar me detaje veprimet ose mosveprimet e kryera. Në këto kushte, gjykata e rrethit ka konkluduar se hetimi kishte qenë i plotë e i gjithanshëm dhe se organi i prokurorisë kishte vepruar në konformitet të plotë me ligjin (*shih paragrafin 35 të vendimit*).

12. Vendimi i gjykatës së rrethit është vlerësuar i drejtë nga gjykata e apelit, e cila i ka dhënë përgjigje të arsyetuar kërkuarit edhe për pretendimet për kryerjen nga ana e organeve ligjzbatuese të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, duke i gjetur ato të pabazuara. Në vijim, ligjshmëria e gjykatave të faktit i është nënshtruar kontrollit të Gjykatës së Lartë, e cila i ka vlerësuar ato në zbatim të drejtë të ligjit material e procedural. Po kështu, Gjykata e Lartë ka arsyetuar në vendimin e saj edhe në lidhje me pretendimet e kërkuarit për mosnjohjen e tij me shpallje për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, si dhe për cenimin nga gjykatat e faktit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih paragrafët 35–41 të vendimit*).

13. Nisur nga sa më lart, rezulton se gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar qëndrimin e tyre për çështjen, duke dhënë përgjigje të argumentuara për pretendimet e ngritura nga kërkuari edhe për fazën e hetimeve, ndaj vlerësoj se procesi gjyqësor, në tërësinë e tij, përfshirë edhe fazën e hetimit penal,

nuk rezulton të ketë qenë i parregullt në këndvështrimin kushtetues. Pra, zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme nuk rezulton të ketë qenë arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ashtu siç edhe shumica ka arsyetuar, çmoj se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së jetës së të birit, si pasojë e procesit hetimor të zhvilluar nga Prokuroria e Tiranës dhe procesit gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për ngjarjen e ndodhur, nuk është i bazuar.

14. Në përfundim, vlerësoj se kërkesa duhej të ishte rrëzuar, sipas arsyetimit të mësipërm.

Anëtare: Fiona Papajorgji

VENDIM

Nr. 119, datë 19.6.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHA NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1054/8 prot., datë 14.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Ayen AS Energji’ sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1054 prot., datë 8.5.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 20.5.2024, vendosi të fillojë procedurën për



licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.5.2024 dhe 22.5.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.5.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen e internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 1054/4 prot., datë 24.5.2024 dhe nr. 1054/6 prot., datë 7.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht.

- Nga korrespondenca e kryer, me qëllim plotësimin e dokumentacionit në kuadër të aplikimit, shoqëria përcolli në ERE dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet shkresave të protokolluara në ERE me nr. 1054/5 prot., datë 30.5.2024 dhe nr. 1054/7 prot., datë 11.6.2024, duke plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

- Kjo shoqëri ka një licencë të vlefshme në këtë veprimtari me nr. 453, seria F19, deri më 24.9.2024. Duke qenë se shoqëria nuk aplikoi brenda datës 24.3.2024, për rinovimin e licencës, subjekti ka bërë aplikim të ri, e si e tillë afatet e licencës në rast miratimi do të fillojnë nga data 25.9.2024.

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), duke filluar nga data 25.9.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të

Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 120, datë 19.6.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHA NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1053/3 prot., datë 14.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Ayen AS Energji’ sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1053 prot., datë 8.5.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 20.5.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.5.2024 dhe



22.5.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.5.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen e internetit të ERE-s.

- Me shkresat me nr. 1054/4 prot., datë 24.5.2024 dhe nr. 1054/6 prot., datë 7.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Nga korrespondenca e kryer, me qëllim plotësimin e dokumentacionit në kuadër të aplikimit, shoqëria përcolli në ERE dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet shkresave me nr. 1054/5 prot., datë 30.5.2024 dhe nr. 1054/7 prot., datë 11.6.2024, duke plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), duke filluar nga data 25.9.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 121, datë 19.6.2024

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 13 dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1083/5 prot., datë 14.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘GSA’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 102, datë 21.12.2009, rinovuar me vendimin nr. 84, datë 16.9.2014, dhe rinovuar sërish me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 127, datë 13.8.2019”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1083 prot., datë 14.5.2024 dhe nr. 1083/1 prot., datë 22.5.2024, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 99, datë 27.5.2024, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 246, seria FK14, të shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. nr. 102, datë 21.12.2009, rinovuar me vendimin nr. 84, datë 16.9.2014 dhe rinovuar sërish me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 127, datë 13.8.2019.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 29.5.2024 dhe 30.5.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 7.6.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u



publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 1083/4 prot., datë 3.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e Bordit, mbi fillimin e procedurave për rinovimin e licencës nr. 246, seria FK14, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 23.12.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 122, datë 19.6.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “FU-GEN” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 886/18 prot., datë 14.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Fu-Gen’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “FU-GEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 886 prot., datë 4.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 62, datë 12.4.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencim e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 886/3 prot., datë 22.4.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet ende në aplikimin e saj.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 1030 prot., datë 2.5.2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të shoqërisë.



- Shoqëria me shkresën nr. 886/4 prot., datë 2.5.2024, ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 93, datë 13.5.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Fu-Gen” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme apo dhe planifikimin e një seance dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE.

- Me shkresën nr. 886/6 prot., datë 22.5.2023, është njoftuar shoqëria për zhvillimin e një seance dëgjimore, në lidhje me dokumentacionin e mbetur ende të pa plotësuar.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 886/7 prot., datë 27.5.2024 dhe nr. 886/8 prot., datë 29.5.2024, nr. 886/11 prot., 886/12 prot., datë 6.6.2024, 886/13 prot., datë 7.6.2024 dhe 886/15 prot., datë 12.6.2024.

- Me vendimin nr. 114, datë 10.6.2024, Bordi i ERE-s, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Fu-Gen” sh.p.k., për arsye të sqarimit/rakordimit të shumës së financimit në referencë të asaj që është përcaktuar nga kontrata me MIE-n dhe për të saktësuar afatin e fillimit të operimit duke qenë se data 1.6.2024 ka kaluar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 886/17 prot., datë 13.6.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion shtesë të aplikimit.

- Nga analizimi i dokumentacionit në referencë të përcaktimeve, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin sa kërkuar në nenin 9, pika 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; pika 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”.

- Rezulton se shoqëria “Fu-Gen” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën nr. 2425 rep., nr. 1570 kol., datë 28.4.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë

elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier nga shoqëria “Fu-Gen” sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaike me rrjetin e shpërndarjes, nëpërmjet shkresës së shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. nr. 6357/3 prot., datë 28.6.2022;

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprak, lëshuar më 10.6.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i impiantit PV Fier”, me vendndodhje në Topojë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për fuqinë e instaluar 2 mw.

- Centrali fotovoltaike parashikohet që të fillojë operimin në muajin shtator të vitit 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Fu-Gen” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Fu-Gen” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 123, datë 19.6.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “NOVA PROSPECT” SHPK,
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1488/1 prot., datë 11.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nova Prospect’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Nova Prospect” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1448 prot., datë 3.6.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 22960, Njësia Administrative Pilur, Bashkia Himarë, qarku Vlorë.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin, në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “b”, “c” dhe “d”;

për pikën 1.3, gerrat “a” dhe “c”; për pikën 2.1, gerrat “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Për sa më sipër është konstatuar se nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni si vijon:

Neni 9. Formatit dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2:

- germa “a”: Shoqëria duhet të shtojë në objektin e veprimtarisë së saj dhe prodhimin e energjisë elektrike.

Pika 1.3:

- germa “b”: Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE mbështetjen financiare për vlerën e mbetur, referuar përcaktimeve të planit të biznesit, si dhe të depozitojë pëlqimin apo qëndrimin e MIE-s, në lidhje me transferimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e nënshkruar me MIE-n, e cila është vendosur si një mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e kredisë bankare.

Pika 2.1:

- germa “a”: Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat mbi llojin e centralit, *on shore* apo *off shore*, si dhe të paraqesë në ERE dokumentacionin teknik mbështetës, në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltai.

- Në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake (deri më 17.8.2024) dhe referuar faktit që shoqëria në shtojcën 2 ka deklaruar se viti i ndërtimit të centralit është 2023–2024 dhe data e fillimit të operimit 30.8.2024, ajo duhet të dokumentojë në ERE fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltai apo fazën në të cilën ndodhet realizimi i ndërtimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2960, Bashkia Himarë, qarku Vlorë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Nova Prospect” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data



e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 124, datë 19.6.2024

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 116, DATË
24.5.2022, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘SPV BLUE 1’ SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ‘BLUE 1’,
ME VENDNDODHJE NË ZONËN E
SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 833/3 prot., datë 14.6.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw”, të ndryshuar, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 116, datë 24.5.2022, të ndryshuar me vendimin nr. 65, datë 12.4.2024, ka vendosur të licencojë shoqërinë “SPV

Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga dokumentimi në ERE i testimit/komisionimit të centralit, por jo më vonë se data 9.7.2026.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 65/2024, me shkresën nr. 833/2 prot., datë 16.4.2024.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 715/3 prot., datë 24.5.2024, shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka bërë me dije se më datë 23.5.2024, ka nënshkruar me shoqërinë “OST” sh.a. “Marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik ‘Blue 1’”, marrëveshje e cila është nënshkruar pas kalimit të fazës së testeveve 72-orëshe të monitoruara nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 715/4 prot., datë 30.5.2024, shoqëria ka depozituar dhe “Marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik ‘Blue 1’”, me nr. 2935 prot., datë 23.5.2024, lidhur ndërmjet “OST” sh.a. dhe shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. Pjesë e kësaj marrëveshjeje janë dhe testimet e centralit të kryera në praninë e përfaqësuesve të “OST” sh.a.

- Duke qenë se shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka dokumentuar testimin dhe energjizimin e centralit fotovoltaik, propozojmë pranimin e kërkesës së saj dhe ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 116/2022, të ndryshuar, duke e nisur fillimin e afatit 25-vjeçar të licencës së saj në datën 23.5.2024.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me



kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 23.5.2024.”

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 125, datë 19.6.2024

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT
QË KONTROLLON INTERESAT E
SHOQËRISË “SMART WATT” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pika 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1210/3 prot., datë 14.6.2024, të Drejtorisë së

Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Smart Watt’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1210 prot., datë 23.5.2024, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1210/1 prot., datë 24.5.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Duke qenë se akti i kalimit të kuotave është nënshkruar përpara se të merrej autorizimi përkatës i ERE-s për këtë transferim, në ERE është depozituar deklarata e përbashkët e dy shoqërive ortake, të cilat nën përgjegjësinë e tyre dhe me vullnet të lirë e të plotë, deklarojnë se në rast të mosmarrjes së miratimit nga ERE për transferimin e kuotave, ky transferim do të jetë i pavlefshëm dhe ato do të kalojnë në gjendjen fillestare, para se të kryhej ky transferim.

- Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Dhënie e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k.



2. Ortaku që kontrollon interesat e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. bëhet “EXO Partners” sh.p.k.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Smart Watt” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 922/9, datë 22.7.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimin të ‘Unazës së Madhe’ Tiranë nga ‘Sheshi Shqiponja’–‘Bulevardi i Ri’ dhe ‘Rikualifikimi i ‘Unazës Lindore’ për lotet 4, 5, 6’, (faza 2)”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 37,677,789.70 (tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

- Për pasurinë “objekt banimi”, është bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 37,677,789.70 (tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, PASURITË E PALUAJTSHME TË TË CILËVE, PREKEN NGA DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 896, DATË 29.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘RISHIKIMI I PROJEKTTIT PËR SEGMENTIN RRUGOR TË VAZHDIMIT TË UNAZËS SË MADHE TË TIRANËS NGA
‘SHESHI SHQIPONJA’ – ‘BULEVARDI I RI’
‘RIKUALIFIKIMI I ‘UNAZËS LINDORE’ PËR LOTET 4, 5, 6’,(FAZA 2)’

Të dhëna sipas VUKA nr. 896, datë 29.12.2022																	Të dhëna e ndryshimit dhe shtesës																																													
Nr	No. ndërtesës sipas VUKA nr. 896/2022	Emri	Adresa	Mblotja	Zona kufitare	Numri i pronës	Sp. totale m ²	Llogji pronës	Total "total"			Total "m"			Objektuesi			Objektuesi themelor		Numri i pronës	Sp. totale m ²	Llogji pronës	Total "total"			Total "m"		Objektuesi			Ndryshimi shtesë		Vlera totale (€)	Shënime																												
									Spërfaqja e objekteve (m ²)	Costi (€)	Vlera totale	Spërfaqja e objekteve (m ²)	Costi (€)	Vlera totale	Spërfaqja e objekteve (m ²)	Costi (€)	Vlera totale	Spërfaqja e objekteve (m ²)	Costi (€)				Vlera totale	Spërfaqja e objekteve (m ²)	Costi (€)	Vlera totale	Spërfaqja e objekteve (m ²)	Costi (€)	Vlera totale	Spërfaqja e objekteve (m ²)	Vlera përcaktuar	Vlera totale (€)																														
1	21	Bogert Elm	Shëtitje Shëtitje	Shëtitje Shëtitje	39%	136/75	3547	Traut+ndërrim	77	479	36,883.00									136/75	3547	Traut+ndërrim	130	479	62,270.00			3327	61,367.00	20,338,260.00	20,402,530.00	Leje legjitimimi nr. 302031 datë 23.10.2022 goditje banimi 5-katëshe sip. e katit parës 863.30 m ² + shtesë 67 parë 802.60 m ² + vlerë 216 m ² e katit 6-të ditë 802.60 m ² shtesë + vlerë 216 m ²																														
2	12	Hali	Xhelo	Canalhat	39%	30/22	230	Traut+ndërrim	100.0	479	46,964.30			375.6	4867	22979325.2				30/22	230	Traut+ndërrim	10	479	15,987.00							30,951.30																														
3	79	Vidula	Nandë	Bila	39%	136/78	480	At			0.00	245.6	448	399,123.00			0			136/78	480	At				130	448	68,498.00				40,498.00																														
4	16	Jugo	Xhelo	Bila	39%	30/53	390	At			0.00	31.2	448	16,875.00			0			30/53	390	At				166	448	6,568.00				6,568.00	Mbledhje pavarësisht ndërrimit nr. 30/10ND) sot. 26.4.1471 kg																													
5	18	Mos Agost Agi	Maliq Nandë	Agos Agos	39%	68/21	380	At			0.00	247.00	448.00	139,650.00			0			68/21	380	At				92.00	448	41,236.00				41,236.00																														
6	28	Haji	Gast	Duat	39%	68/77	311	At			0.00	192.50	448.00	66,360.00			0			68/77	311	At				193.3	448	52,088.00				51,888.00																														
7	23	Lukicini	Hatun	Duat	39%	136/565	2233	Traut+ndërrim	11.2	479	5,364.80			0.00			0			136/565	2233	Traut+ndërrim	11.7	479	5,684.30							5,684.30	Leje legjitimimi nr. 97786, datë 15.10.2022 goditje banimi 2-katëshe +1 kat shtesë sip. e katit shtesë 47.5 m ² sip. katit parës 863.30 m ² sip. e katit 6-të parë 802.60 m ²																													
8	32	Gjini	Martala	Laci	87%	5/121	380	Traut+ndërrim	164	3209	5,396,599.20			0.00	80.00	95,397.00	963997			5/121	380	Traut+ndërrim	66.8		32,878.0	2,796,254.40						2,796,254.40	Vendosje nr. 226, datë 27.10.2021, për ndërrim e shtesës për katet parës dhe objekteve pa ndërrim parësor me vendosje funksionale																													
9	26	Isaull	Kacem	Spja	39%	68/32	570	At			0.00	1,072.30	448.00	498,790.40			0			68/32	570	At				62.5	448	274,488.00			274,488.00	Mbledhje pavarësisht ndërrimit nr. 68/125-ndërrim 12-ndërrim 68/125																														
10	33	Martala	Bashin	Anda	83%	7/66	485	Traut+ndërrim	286.2	2378	5,124,586.00			0.00			0			7/66	485	Traut+ndërrim						286.7	68,959.00	14,018,722.30	14,018,722.30	Leje legjitimimi nr. 103338, datë 30.10.2020 goditje banimi 2-katëshe me sip. katit parës 863.30 m ² sip. katit 6-të parë 802.60 m ² sip. vlerë 216 m ² sip. katit 6-të parë 802.60 m ²																														
Shënim: 68/68																	43,951,025.80																							27,677,789.70																						
Gjeneratë pronës e 68/parë + ndërrim sipas ligjit funksional sipas VUKA nr. 896/2022																																																														
Gjeneratë e ndryshimit dhe shtesës sipas VUKA nr. 896/2022																																																														

**KORRIGJIM GABIMI**

Në njoftimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 4719, datë 27.3.2024, “Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Republikën e Italisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 5.4.2024, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Titulli ndryshohet nga:

“Marrëveshja Ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Italiane mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”, nënshkruar më 6 nëntor 2023 dhe hyrë në fuqi më 25.3.2024, në:

“Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Italiane mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”, nënshkruar më 6 nëntor 2023 dhe hyrë në fuqi më 25.3.2024.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 144 lekë